



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 26/148

Datë: 29.06.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTARSTVO PRAVDE / MINISTRY OF JUSTICE

**KONCEPT DOKUMENTI PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE CIVILE PËRFSHIRË
TË DREJTËN E PALËVE PËR GJYKIM BRENDË KOHËS SË ARSYESHME**

Qershor 2023

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE E KONCEPT DOKUMENTIT	4
HYRJE	5
KAPITULLI 1: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	8
1.1. Problemi kryesor, shkaqet dhe efektet	8
1.2. Korniza e legjislacionit dhe politikave të Kosovës	9
1.3. Të dhënat, raportet dhe mekanizmat e sistemit të drejtësisë dhe të dhënave tjera në lidhje me trajtimin e lëndëve gjyqësore	12
1.4. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për shkeljen e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (gjykimi brenda kohës së arsyeshme)	27
1.4. Standardet relevante ndërkombëtare	29
1.4.1. Standardet e Jurisprudencës të GJEDNJ	29
1.4.2. Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ): Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (CEPEJ(2018)26)	33
1.5. Praktikrat e shteteve evropiane.....	33
KAPITULLI 2: SYNIMET DHE OBJEKTIVAT	39
KAPITULLI 3: OPSIONET	40
3.1. Opsioni “asnjë ndryshim”	40
3.2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore	41
3.3. Opsioni për realizimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor përmes ndryshimeve ligjore	43
3.4. Opsioni për realizimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor përmes përmirësimit e zbatimit të legjislacionit aktual dhe ndryshimeve të reja ligjore.....	46
3.5. Opsioni i realizimit të së drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme në Gjykatën Kushtetuese ...	47
KAPITULLI 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme.....	48
4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave	50
KAPITULLI 5: KOMUNIKIMI DHE KONSULTIMI	50

KAPITULLI 6: KRAHASIMI I OPSIONEVE	51
6.1. Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme.....	53
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet	62
KAPITULLI 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm.....	63
7.1. Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin	64
SHTOJCA 1: FORMA E VLERËSIMIT PËR NDIKIMIN EKONOMIK.....	65
SHTOJCA 2: FORMA E VLERËSIMIT PËR NDIKIMET SHOQËRORE.....	69
SHTOJCA 3: FORMA E VLERËSIMIT PËR NDIKIMET MJEDISORE.....	74
SHTOJCA 4: FORMA E VLERËSIMIT PËR NDIKIMIN E TË DREJTAVE THEMELORE.....	77

Përmbledhje e koncept dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept dokumenti për realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Integrimet Evropiane dhe Koordinim të Politikave (DIEKP)
Personi kontaktues	Ruzhdi Osmani, Zv. Drejtor DIEKP, 038 200 18 092
PKZH	Ky koncept dokument është i paraparë në listën e koncept dokumenteve për vitin 2023
Prioriteti strategjik	Drejtësi me kohë
Vendimi	
Çështja kryesore	Zgjidhja e problemit të zbatimit të së drejtës për gjykimin brenda kohës së arsyeshme
Përmbledhje konsultimeve	e Parashihet që të realizohen konsultimet paraprake
Opsioni i propozuar	Opsioni 4
Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Në tabelat e mëposhtme janë dhënë ndikimet buxhetore
Ndikimet ekonomike	Në tabelat e mëposhtme janë dhënë ndikimet ekonomike
Ndikimet shoqërore	Në tabelat e mëposhtme janë dhënë ndikimet shoqërore
Ndikimet mjedisore	Në tabelat e mëposhtme janë dhënë ndikimet mjedisore
Ndikimet ndër-sektoriale	Ndikimi në të drejtat themelore, gjinore dhe në drejtësinë sociale
Ngarkesat administrative	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori
Testi i NVM-ve	Ky test nuk është relevant për këtë koncept dokument.
Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Hartimi dhe miratimi i ligjit për të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme
Afatmesëm	n/a

Hyrje

Bazuar në Kushtetutën e Kosovës, të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit¹. Të gjithë gëzojnë të drejtën për mbrojtje të barabartë juridike pa diskriminim dhe parimet e mbrojtjes së barabartë juridike nuk parandalojnë vendosjen e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozita jo të barabarta².

Shtetet kanë detyrimin e përgjithshëm për të zgjidhur problemet në të cilat shtrihen shkeljet e gjetura dhe të sigurojnë që mjetet juridike kombëtare janë efektive në ligj dhe në praktikë.

E drejta e gjyqimit brenda afatit të arsyeshëm është e drejtë themelore procedurale e njeriut e garantuar me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë themelore të Njeriut (KEDNj). Kjo e drejtë shërben si garanci për mbrojtjen e palëve nga zvarritjet e paarsyeshme të procedurave.³

Zvarritja e procedurave gjyqësore është një problem shumë kompleks me të cilin përballen shumë shtete evropiane: për disa prej tyre është një problem i përgjithësuar, "sistematik", ndërsa për të tjerat më tepër duhet parë si një mosfunksionim i rastësishëm i një sistemi përndryshe efektiv të administrimit të drejtësisë.⁴ Shpejtësia e procedurës është vetëm njëri element i së drejtës për të pasur një proces gjyqësor të rregullt, i cili gjithsesi duhet të trajtohet në mënyrë të duhur sa i përket një procedure të drejtë.

Megjithëse ligjet procedurale parashohin përcaktimin e afateve ligjore për përdorimin e mjeteve juridike (ankesa, përgjigja në padi), mungojnë mekanizmat e duhur në lidhje me monitorimin e afërt të procesit gjyqësor, i cili kërkon që çdo gjykatë të arrijë të mbledhë të dhëna në lidhje me secilën fazë individuale të procesit gjyqësor. Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK), neni 394 dhe neni 395 përcaktojnë afatin prej prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për përgjigje në padi nga dita kur është paraqitur në gjykatë padia e rregullt dhe e plotë. Po ashtu me rastin e dërgimit të padisë gjykata do ta udhëzojë të paditurin për detyrimin, për përmbajtjen që duhet ta ketë përgjigja në padi si dhe për pasojat procedurale në rast se nuk e paraqet në gjykatë, brenda afatit të duhur, përgjigjen në padi. Neni 400 i LPK-së poashtu përcakton edhe afatet për mbajtjen e seancës përgatitore, kryesore dhe afatin për nxjerrjen e aktgjyqimit. Neni 400 i LPK-së përcakton se pasi të arrijë përgjigja në padi gjykata e konvokon seancën përgatitore. Po që se i padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi, e nuk janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjyqimit kontumacional, gjykata do ta konvokojë seancën përgatitore pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e përgjigjes në padi. Seanca përgatitore mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën gjykatës i ka arritur përgjigja në padi e të paditurit. Neni 420 paragraf 2 i LPK-së përcakton se seanca kryesore do të mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën është mbyllur seanca përgatitore. Tutje, neni 153 paragraf 1 i LPK-së parashih që Gjykata e jep aktgjykimin më së voni brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor.

¹ Neni 24 i Kushtetutës së Kosovës

² Neni 24 i Kushtetutës së Kosovës

³ Neni 6 i KEDNj-së

⁴ Komisioni i Venecias, Raport mbi efektivitetin e mjeteve juridike kombëtare në lidhje me tejzgjatjen e procedurave, CDL-AD(2006)036rev, prill 2007

Te procedurat e posaçme kontestimore, (lëndët me prioritet si pengim posedimi, kontestet e punës), janë përcaktuar afate me të shkurtëra për vendosje nga gjykata. LPK përcakton me nenin 479 të saj se me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjykata gjithmonë i kushton kujdes nevojës së zgjidhjes së ngutshme të kontesteve për shkak të pengimit të posedimit, por duke marrë parasysh natyrën e secilit rast konkret. Tek kontestet e punës, gjykata gjithashtu gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës. Në aktgjykimin me të cilin urdhërohet përmbushja e ndonjë detyrimi nga konteste marrëdhënjet së punës gjykata cakton afat shtatë (7) ditor. LPK poashtu përcakton edhe afatet për paraqitjen e mjeteve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme juridike⁵ dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike ku janë përcaktuar edhe afatatet kur duhet të vendosë Gjykata e shkallës së dytë.⁶

Ligji për Konfliktet administrative gjithashtu parasheh afate procedurale sa i përket nxjerrjes së vendimeve nga gjykata dhe paraqitjen e mjeteve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme juridike.⁷ Neni 47 i Ligjit për Konflikte Administrative përcakton se nëse është zhvilluar shqyrtimi verbal, menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit verbal dhe këshillimit, gjykata shpallë aktgjykimin, respektivisht vendimin. Megjithatë në këtë drejtim Ligji do të duhej të parashihte afatin për nxjerrjen e aktgjykimit. Neni 65 i Ligjit poashtu obligon organin kompetent kur në rast të vendosjes në vend të aktit të anuluar administrativ, të nxirret një tjetër, organi kompetent ka për detyrë ta nxjerrë pa shtyrje, jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të aktgjykimit. Organi kompetent, në këtë rast, është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën.

Ndërkaq, afatet kohore për përfundimin e lëndëve të cilat prokurorët e Shtetit i kanë në punë janë të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale, konkretisht neni 84 dhe neni 157 që përcaktojnë afatet kohore si dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren nga ana e prokurorëve të Shtetit që nga momenti i pranimit të kallëzimit penal e deri tek ngritja e aktakuzës si: Neni 84 i Kodit të Procedurës Penale i cili përcakton se brenda 30 ditësh pas pranimit të kallëzimit penal, prokurori i shtetit nxjerr aktvendim të shkruar me të cilin e hedh kallëzimin penal ose kërkon informacione shtesë në pajtim me nenin 83 të Kodit. Nëse prokurori i shtetit ka kërkuar informacione shtesë, ai nxjerr aktvendim për hedhjen e kallëzimit penal brenda gjashtë (6) muajsh nga dita e paraqitjes së kallëzimit penal fillestar.

Në nenin 157 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se nëse hetimi është filluar, ai përfundon brenda dy (2) viteve.

⁵ LPK, neni 176

⁶ LPK, neni 211 (revizioni), 234 (përsëritja e procedurës), 245 (kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë)

⁷ Ligji për Konfliktet Administrative, neni 49 – neni 62)

Andaj, ligjet procedurale të sipërpërmendura parashohin shprehimisht afatet ligjore për përdorimin e mjeteve juridike si dhe afatet ligjore për veprimin e gjykatës. Megjithatë këto ligje nuk parashohin mjete efektive juridike për adresimin e mosveprimit të institucioneve përgjegjëse në ato raste kur janë të detyruara të veprojnë.

Njëra nga çështjet më kritike me të cilat përballet gjyqësori i Kosovës janë lëndët e pazgjidhura (lëndët e vjetra të grumbulluara si dhe numri i madh i lëndëve të pranuar). Zgjidhje e këtij problemi, është edhe një nga parakushtet e arritjes së standardit për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Raportet e Komisionit Evropian për Kosovë, raportet e organizatave të shoqërisë civile, në mënyrë të vazhdueshme theksojnë se lëndët e grumbulluara, sidomos në procedurë civile dhe ekzekutimi i aktgjykimeve mbetet sfidues dhe bën thirrje për një sistem gjyqësor efektiv dhe shërbimin me kohë të drejtësisë.⁸

Duhet theksohet po ashtu se sipas Ligjit për Gjykatat⁹, çdo gjyqtar duhet të ketë së paku nga një bashkëpunëtor profesional, që i shërben ekskluzivisht gjyqtarit në fjalë. Megjithatë, në Gjykatën Themelore të Prishtinës një bashkëpunëtor profesional ju shërben dy gjyqtarëve.¹⁰ Rëndësia e bashkëpunësorëve profesional është jashtëzakonisht e madhe në shkurtimin e kohës së zgjidhjes së lëndëve. Bashkëpunëtori profesional ndihmon në përgatitjen e vendimeve të shkruara, aktgjykimeve, vendimeve të tjera, duke siguruar materiale të domosdoshme juridike, duke bërë shqyrtimin e ligjeve.

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept dokumenti për realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
Personi kontaktues	Ruzhdi Osmani, Zv. Drejtor DIEKP, 038 200 18 092
Plani Kombëtar për Zhvillim	Drejtësi efektive
Prioriteti strategjik	Drejtësi me kohë
Grupi punues	Ruzhdi Osmani , Zv. Drejtor, DIEKP/MD, kryesues Albulena Uka , Kordinatore për CEPEJ, DMLPPL/MD, zëvendës kryesuese Nexhat Kelmendi , Këshilltari i lartë kushtetues juridik/GJK, Eros Gashi , Kabineti i Ministrisë së Drejtësisë/MD Afrim Shala , Gjyqtar në Gjykatën e Apelit/KGJK Zenel Leku , Gjyqtar në Gjykatën e Apelit/KGJK

⁸ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2020, 2021

⁹ Neni 39 paragrafi 2 i Ligjit për Gjykatat

¹⁰ Intervista me gjyqtarë

	Florentina Beqiraj , Koordinatore e Njesisë për të drejtat e njeriut/MD Kaltrina Nuhiu , Zyrtare Ligjore, DL/MD Saranda Salihu , Zyrtare për analizë dhe monitorim të Medieeve/MD Gëzim Bislimi , Analist i lartë i buxhetit/MFPT Sadedin Gërguri , Divizioni për buxhet e financa/MD Kushtrim Canolli , Zyrtar i lartë për planifikim të politikave, ZPS/ZKM Alberita Hyseni , Zyrtare e Lartë Ligjore, ZL/ZKM Dodona Gashi , zyrtare e lartë, ZKP/ZKM Leotrim Gashi , IKD Rinor Hoxha , ekspert ligjor Albina Qestaj , praktikante/MD
--	--

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

1.1. Problemi kryesor, shkaqet dhe efektet

Në pemën e problemit më poshtë është përcaktuar problemi kryesor që është krijuar nga shkaqet të ndryshme. Ky problem krijon efekte të caktuara tek palët që janë përballur me vonesat në gjykata. Të gjitha këto janë elaboruar në vijim.

Figura 2: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	Shkelja e të drejtës themelore për gjykim brenda kohës së arsyeshme
	Humbja e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë
	Shkaktimi i dëmve materiale dhe jomateriale të qytetarëve që përballen me procedura të tejzgjata gjyqësore
Problemi kryesor	Numri i madh i rasteve të pazgjidhura dhe tejzgjatja e proceseve gjyqësore
Shkaqet	Mungesa e kuadrit të nevojshëm profesional: gjyqtarë dhe bashkëpunëtorë profesionalë
	Mungesa e mekanizmave ligjorë për zbatimin e të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme

	Efekti “ping pong” ndërmjet gjykatave të apelit dhe gjykatave themelore
--	---

1.2. Korniza e legjislacionit dhe politikave të Kosovës

Republika e Kosovës ka një numër të konsiderueshëm aktesh ligjore lidhur me normimin dhe garantimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor. Kjo kornizë ligjore dp të elaborohet në tabelën e mëposhtme.

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me Gazetën Zyrtare	Institucioni (-et) shtetëror (e) përgjegjës (e) për zbatim	Roli dhe detyrat e institucionit (-eve)
Kushtetuta e Republikës së Kosovës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702	Institucionet e Republikës së Kosovës	Kushtetuta garanton barazi para ligjit për të gjithë qytetarët. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Sipas Kushtetutës parimet e mbrojtjes së barabartë juridike nuk parandalojnë vendosjen e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozita jo të barabarta.
Ligji për Gjykatat	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykatat Ministria e Drejtësisë	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Sipas Ligjit për Gjykatat, çdo gjyqtar duhet të ketë së paku nga një bashkëpunëtor profesional, që i shërben ekskluzivisht gjyqtarit në fjalë.
Ligji për Procedurën Kontestimore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2583	Gjykatat, (palët në procedurë) Ministria e Drejtësisë	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Ligji për Procedurën Kontestimore rregullon afatet kohore brenda të cilave duhet të kryhen veprimet e nevojshme nga palët në procedurë. LPK poashtu përcakton edhe

			afatet për paraqitjen e mjeteve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme juridike dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike ku janë përcaktuar edhe afatatet kur duhet të vendosë Gjykata e shkallës së dytë.
Ligji për Konfliktet Administrative	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2707	Gjykatat Ministria e Drejtësisë	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Ky ligj parasheh afate procedurale sa i përket nxjerrjes së vendimeve nga gjykata dhe paraqitjen e mjeteve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme juridike. Ligji poashtu obligon organin kompetent kur në rast të vendosjes në vend të aktit të anuluar administrativ, të nxirret një tjetër, organi kompetent ka për detyrë ta nxjerrë pa shtyrje, jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të aktgjykimit. Organi kompetent, në këtë rast, është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën.</p>
Ligji për Gjykatën Kushtetuese	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2614	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Kushtetuese Ministria e Drejtësisë	<p>Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit</p> <p>Zbatimi i legjislacionit: Ligji për Gjykatën Kushtetuese përcakton se çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.</p>

Ligji për Procedurën Përmbartimore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870	Gjykatat dhe përmbartuesit privat Ministria e Drejtësisë	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbartuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.
Kodi i Procedurës Penale	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861	Prokuroritë, gjykatat, policia, institucionet tjera zbatuese të ligjit.	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit Ky Kod ka për qëllim përcaktimin e rregullave të procedurës penale të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë së shtetit si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale të paraparë me këtë Kod.
Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18335	Ministria e Drejtësisë Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit; Këshilli është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij dhe gëzon pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutë dhe me lig. Këshilli siguron që gjykatat të respektojnë parimet e mosdiskriminimit, proporcionalitetit, si dhe të drejtat e njeriut dhe të barazisë gjinore, të garantuara me Kushtetutë dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen në Republikën e Kosovës.

Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2709	Ministria e Drejtësisë Këshilli Prokurorial i Kosovës	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Këshilli është një institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një sistemi prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm siç përcaktohet me Kushtetutë dhe me ligj. Këshilli siguron që prokuroritë të respektojnë parimet e mosdiskriminimit, proporcionalitetit, si dhe të drejtat e njeriut dhe të barazisë gjinore, të garantuara me Kushtetutë dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen në Republikën e Kosovës.
Ligji për Akademinë e Drejtësisë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13318	Ministria e Drejtësisë Akademia e Drejtësisë	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Sipas këtij Ligji, Akademia e Drejtësisë rregullon mënyrën dhe kushtet sipas të cilave kryhet trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të Republikës së Kosovës, trajnimi i personelit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe çështje të tjera.

1.3. Të dhënat, raportet dhe mekanizmat e sistemit të drejtësisë dhe të dhënave tjera në lidhje me trajtimin e lëndëve gjyqësore

Në vijim koncepti i dokumenti referohet raporteve që nxjerrin në mënyrë periodike KGJK, KPK, raporteve të organizatave të shoqërisë civile (në lidhje me kohëzgjatjen e përfundimit të lëndëve) si dhe intervistave me gjyqtarë, në lidhje me ngarkesën me lëndë, normën e gjyqtarëve, mesataren e përfundimit të lëndëve dhe raportit midis lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura brenda periudhave të caktuara kohore.

➤ Të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK)

KGJK përgatit raporte mujore dhe vjetore në lidhje me numrin e lëndëve, ngarkesën e gjyqtarëve dhe efikasitetin në përfundimin/zgjidhjen e lëndëve sipas natyrës së tyre (bazuar në standardet e normës për gjyqtarë). Në vijim, ky koncept dokument i referohet Raportit vjetor të vitit 2022, Raportit statistikor për punë e gjykatave për gjashtëmujorin e I-rë të vitit 2022 (01.01.2022 – 30.06.2022), Raportin për vitin 2021 dhe Raportin për 2020.

Raportet pasqyrojnë numrin e lëndëve sipas llojeve, duke përfshirë edhe një analizë të shkurtër mbi ngarkesën e gjyqtarëve me lëndë të rënda dhe të lehta (siç klasifikohen në bazë të natyrës së tyre), për efikasitetin e gjyqtarit në zgjidhjen e lëndëve, si dhe për mesataren në nivel të Kosovës.

Sipas raportit vjetor të vitit 2022, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve ka qenë 404 prej të cilëve 385 kanë zgjidhur lëndë.¹¹

Raporti i gjashtëmujorit të I-rë prezanton numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve në gjykatat e Kosovës, që është 388 gjithsej (Gjykata Supreme 18, Dhoma e Posaçme 15, Gjykata e Apelit 56 dhe Gjykatat Themelore 299), nga të cilët lëndë kanë zgjidhur 375 prej tyre (brenda 6 mujorit të I-rë të vitit 2022). Gjithashtu, në raport paraqitet edhe numri i përgjithshëm i stafit mbështetës (shërbyes civil) që është gjithsej 1,507¹².

Gjithashtu, në raport prezantohet numri i përgjithshëm i lëndëve që gjyqtarët kanë pasur në punë gjatë periudhës raportuese 6 mujore, në të gjitha nivelet e gjykatave që janë 295,590 lëndë gjithsej (nga të cilat 222,314 janë lëndë të trashëguara dhe 73,276 lëndë të pranuar gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2022). Nga ky numër i lëndëve, gjykatat kanë zgjidhur brenda kësaj periudhe 59,261 lëndë, ndërsa 236,329 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura. Nga ky numër i përgjithshëm i lëndëve në të gjitha nivelet e gjykatave për gjashtëmujorin e I-rë raportues të vitit:

- Gjykata Supreme ka pasur në punë: 1150 lëndë, nga ato: të trashëguara 406, të pranuar 744, të zgjidhura 737 dhe të mbetura si të pazgjidhura 413);
- Dhoma e Posaçme ka pasur në punë: 16.469 lëndë, nga ato: (të trashëguara 15.665, të pranuar 804, të zgjidhura 1.517 dhe të mbetura si të pazgjidhura 14.952);
- Gjykata e Apelit ka pasur në punë: 24.021 lëndë, nga ato: (të trashëguara 15.064, të pranuar 8.957, të zgjidhura 8730 dhe të mbetura si të pazgjidhura 15.291);
- Gjykatat Themelore kanë pasur në punë: 253.950 lëndë, nga ato: (të trashëguara 191.179, të pranuar 62.771, të zgjidhura 48.277 dhe të mbetura si të pazgjidhura 205.673).

Nga kjo del se në përgjithësi (në të gjitha nivelet e gjykatave), numri i lëndëve të zgjidhura është më i vogël se numri i lëndëve të pranuar brenda periudhës raportuese, e kur kësaj i shtohet edhe numri i lëndëve që janë trashëguar (*lëndë që kanë qenë në punë gjatë periudhës raportuese*), del se numri i lëndëve të zgjidhura është i vogël, dhe kjo e rritë edhe me shumë numrin e lëndëve të

¹¹ Raporti i qasshëm në: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf

¹² Raporti statistikor i KGJK për punën e gjykatave për gjashtëmujorin e I-rë të vitit 2022 (01.01.2022 – 30.06.2022). Raporti i qasshëm në: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/31910_KGJK_Raporti_gjashtemujor_pare_2022.pdf

trashëguara për periudhën pasuese (gjashtëmujorin e II-të të vitit 2022, ku të pazgjdhura, që trashëgohen mbesin 236 329 lëndë) në krahasim me periudhën raportuese (gjashtëmujori i I-rë i vitit 2022, ku të trashëguara kanë qenë 222,314 lëndë), ku dallimi është 14,015 lëndë me shumë. Kjo gjendje, shtron nevojën për efikasitet me të madh, që do të përfshinte edhe gjykim në kohë të arsyeshme. Andaj, konkluzioni kryesor është se bazuar në kapacitetet aktuale, sidomos numrin e gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, ka një trend të rritjes së numrit të lëndëve të pazgjdhura, e rrjedhimisht vonesa në zgjidhjen e lëndëve.

Raporti paraqet edhe ngarkesën sipas llojit të lëndëve (penale, civile, ekonomike, etj.) i cili reflektohet në tabelat më poshtë bazuar në të dhënat nga KGJK.

Gjykata	Numri i lëndëve në punë	Numri i lëndëve të trashëguara	Numri i lëndëve të pranuar	Numri i lëndëve të zgjidhura	Numri i lëndëve të pazgjdhura
Gjykata Supreme	1150	406	744	737	413
Dhoma e posacme	16469	15665	804	1517	14952
Gjykata e Apelit	24021	15064	8957	8730	15291
Gjykata Themelore	253950	191179	62771	48277	205673
Gjithsej	295590	222314	73276	59261	236329

Tabela 1: Numri i lëndëve në Gjykata në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022

Gjykata	Numri i lëndëve në punë	Numri i lëndëve të trashëguara	Numri i lëndëve të pranuar	Numri i lëndëve të zgjidhura	Numri i lëndëve të pazgjdhura
Gjykata Supreme	1974	392	1582	1568	406
Dhoma e posacme	19008	17364	1644	3343	15665
Gjykata e Apelit	31151	10811	20340	16087	15064
Gjykata Themelore	284836	145708	139128	91170	193666
Gjithsej	336969	174275	162694	112168	224801

Tabela 2: Numri i lëndëve në Gjykata në vitin 2021

Gjykata	Numri i lëndëve në punë	Numri i lëndëve të trashëguara	Numri i lëndëve të pranuar	Numri i lëndëve të zgjidhura	Numri i lëndëve të pazgjdhura
Gjykata Supreme	1580	171	1409	1188	392
Dhoma e posacme	22157	20936	1221	3222	18935
Gjykata e Apelit	25859	11640	14219	15048	10811
Gjykata	198706	110981	87725	52792	145914

Themelore					
Gjithsej	248302	143728	104574	72250	176052

Tabela 3: Numri i lëndëve në Gjykata në vitim 2020

Sipas tabelave, vërejmë se ka një trend të rritjes së numrit të lëndëve të pranuar gjatë vitit 2021 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2022. Në fund të periudhës raportuese kemi edhe numër të madh të numrit të lëndëve të pazgjidhura ku për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, total të pazgjidhura kanë mbetur 236,329 lëndë në total. Si përfundim del se, ky trend sa i takon zgjidhjes së lëndëve është tregues negativ në raport me garantimin e të drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme. Kjo e bën të domosdoshme edhe rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, përveç masave tjera që duhet të ndërmerren për garantimin e të drejtës së qytetarëve për gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

Vlen të theksohet se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.241/2022, të datës 31 maj 2022, ka miratuar Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025, lidhur me Efikasitetin dhe Prioritizimin e Lëndëve brenda Sistemit Gjyqësor.¹³ Ky plan ka për qëllim adresimin dhe zgjidhjen e lëndëve që janë me prioritet, përfshirë lëndët e kthyer në rigjykim, lëndët të cilat janë me prioritet të lartë sipas ligjeve përkatëse, lëndët më të vjetra se 2 vite dhe lëndët të tjera për të cilat duhet të ndërmerren veprime të përshpejtuara. Ky plan ka për objektiv rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit në trajtimin e lëndëve, forcimin e kapaciteteve të gjyqësorit në trajtimin e numrit të madh të lëndëve që hyjnë në kuadrin e lëndëve me prioritet të lartë, sigurimin e procedurës së drejtë gjyqësore, si dhe përcaktimi i kriterëve të prioritizimit të natyrës së caktuar të lëndëve. Duke pas parasysh rendësinë e planeve strategjike për sistemin gjyqësor në Republikën e Kosovës, KGJK-ja me vendimin KGJK.nr.397/2022, të datës 20 tetor 2022, ka themeluar komisionin për Monitorim, vlerësim dhe raportimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025, si dhe Planin Strategjik për zgjidhje efektive të lëndëve të korrupsionit dhe krimin të organizuar 2022-2024, i cili përbëhet prej pesë (5) gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të republikës së Kosovës.

Në vijim do të paraqiten të dhënat sipas natyrës së lëndëve:

a) Lëndët penale

Për 6 mujorin e I-rë të vitit 2022¹⁴ në nivel të gjykatave themelore, ka pasur ngarkesë me lëndë si në vijim: Penale e përgjithshme - Procedurë paraprake (3,726 lëndë në punë, prej tyre lëndë në pritje në fillim të periudhës raportuese 2,101 lëndë, ndërsa lëndë të pranuar në periudhën raportuese janë 1,625 lëndë. Lëndë të zgjidhura janë 1,332 kurse norma e zgjidhjes është 82 %. Lëndë në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite janë 979 lëndë. Mesatarja e kohëzgjatjes së lëndëve të zgjidhura është 38.38 ditë, ndërsa mesatarja e vjetërsisë së lëndëve që janë në pritje në fund të periudhës raportuese është 600.03 ditë). Këto të dhëna pasqyrohen edhe për lëndët penale në fazat dhe departamentet e tjera.

¹³ Planet strategjike të KGJK të qasshme: <https://www.gjyqesori-rks.org/planet-strategjike/>

¹⁴ Raporti statistikor i KGJK për punën e gjykatave për gjashtëmujorin e I-rë të vitit 2022 (01.01.2022 – 30.06.2022). Raporti i qasshëm në: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/31910_KGJK_Raporti_gjashtemujor_pare_2022.pdf

Duhet nënvizuar se të dhënat me lartë, të ofruara nga KGJK kanë të bëjnë vetëm me mesataren e trajtimit të lëndëve në faza të procedurës penale, dhe jo në lidhje me kohëzgjatjen e zgjidhjes përfundimtare të çështjes penale, që nënkupton edhe standardin e vlerësimit të gjykimit në kohë të arsyeshme (që një të dhënë të tillë, nuk e pasqyrojnë të dhënat/raportet e KGJK-së). Shembull: në procedurën parapake në nivel të Gjykatave Themelore, del se mesatarja e zgjidhjes së lëndëve penale në këtë fazë është 38.38 ditë (që pasqyron vetëm periudhën raportuese 6 mujore), ndërsa mesatarja e lëndëve në pritje për trajtim në këtë fazë është 600.03 ditë, që po ashtu nuk është tregues i kohëzgjatjes mesatare që mund të vlerësohet në kuptim të kohës së arsyeshme për përfundimin e lëndëve.

Më tej, prej të dhënave të prezantuara nga raportet e KGJK-së dhe nga raportet mbi monitorimin e rasteve konkrete në procedurë penale pranë gjykatave themelore, del se vonesat në përfundimin e lëndëve penale janë shumë të mëdha.

Kështu, sipas të dhënave që dalin nga monitorimi i rasteve në procedurë penale edhe nga organizatat e shoqërisë civile, del se këto raste të cilat procedohen nëpër gjykatat tona zgjasin me vite të tëra, duke tejkaluar standardin e vendosjes në kohë të arsyeshme.¹⁵ Shembull: Në një rast penal në Gjykatën Themelore në Prishtinë në të cilin është ngritur aktakuza më 16.07.2007, procedura gjyqësore është në zhvilluar për me shumë se 13 vite (Rasti PKR.nr. 423/14), e ku konstatohet se edhe ndërmarrja e masave nga gjykata për mbajtjen e seancave janë minimale.

Në Gjykatën Themelore të Prizrenit, në një çështje penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare aktakuza është ngritur më datë 11.12.2014, ndërsa nuk ka ndonjë vendim të plotfuqishëm për të, as në vitin 2020 (Rasti PKR.nr. 66/19). Ky rast është kthyer dy herë në rigjykim, gjë që ka ndikuar në zvarritjen e kësaj procedure në masë të madhe. Ky rast tregon se ashtuquajturi “*efekti ping pong*” (që përmendet në raportet e referuara në këtë koncept dokument për lëndët administrative) është i shprehur edhe në çështjet penale. Gjithashtu edhe në Gjykatën e Gjilanit është hasur në një rast të pazgjidhur edhe pas 8 viteve nga ngritja e aktakuzës. Aktakuza e datës 22.10.2012 akuzon një person për falsifikim të parasë, dhe si i tillë nuk është përfunduar as në vitin 2020 (Rasti PKR.nr.175/13). Pastaj edhe në Gjykatën Themelore të Pejës, në një rast penal të uzurpimit të paligjshëm të pronës së huaj (Rasti P.nr.433/16), për aktakuzën e ngritur me datë nuk ka arritur të përfundohet as në vitin 2020, pra, afërsisht 5 vite. Ngjashëm edhe në Gjykatën Themelore të Gjakovës, në një procedurë penale të filluar sipas aktakuzës së datës 25.05.2016 nuk ka marrë vendim as në vitin 2020 (Rasti PKR.nr.64/18) duke bërë që të kalojnë pothuajse 5 vite pa asnjë vendim të gjykatës së shkallës së parë.¹⁶

Nga kohëzgjatja e rasteve si me lartë, problemi edhe më i madh i vonesave në përfundimin e rasteve dhe mos respektimi i standardit për gjykim në kohë të arsyeshme, konsiston në faktin se të gjitha këto raste të lartëpërmendura janë në procedurë të shkallës së parë (gjykatat themelore), me përjashtim të rastit në GJ.Th. në Prizren, ku çështja është kthyer dy herë në rigjykim nga Gjykata e Apelit. Nëse merret në konsideratë edhe kohëzgjatja potenciale në procedurën e Gjykatës së Apelit, si shkallë e dytë, apo edhe në Gjykatën Supreme, që si shkallë e tretë, sipas

¹⁵ Aplikimi i gjykimit të drejtë brenda një afati të arsyeshëm në gjykatat e Republikës së Kosovës, Analizë nga Drejtësia sot, GLPS, Prill 2020.

¹⁶ *Ibid.*

mjeteve të jashtëzakonshme juridike, del se koha mesatare e përfundimit të këtyre lëndëve është tepër e gjatë, dhe tejkalon edhe mesataren e disa lëndëve civile apo administrative.

Në anën tjetër, nga të dhënat e raportit të KGJK-së, që janë referuar më lartë, të vëna në pah janë statistikatat në lidhje me performancën e gjyqtarëve, normën e lëndëve dhe aspekte tjera që kryesisht kanë të bëjnë me ngarkesën e gjyqtarëve me lëndë, por nuk ka një mekanizëm mbi vlerësimin e standardit për gjykimin në kohë të arsyeshme. Vënia e këtij standardi, do të nënkuptonte kriteret e sakta mbi mesataren e zgjidhjes së lëndëve të një natyre të caktuar dhe mbi këtë bazë të bëhet edhe vlerësimi i performancës së gjyqtarëve në lidhje me këtë standard. Kjo mbetet sfidë për sistemin e drejtësisë, duke mos garantuar të drejtën themelore të qytetarëve që përveç një gjykimi të drejtë, çështja e tyre të përfundohet brenda një kohe të arsyeshme.

Siç vërehet nga raporti statistikor (për gjashtëmuajorin e I-rë të vitit 2022) për dallim nga lëndët e trajtuara referuar në Draft Rregulloren për Normën e Gjyqtarëve (e cila ka qenë në konsultim publik në vitin 2022), e njëjta përcakton normën e punës së gjyqtarëve në bazë të numrit të lëndëve të cilat duhet zgjidhur brenda një muaji dhe viti kalendarik (bazuar në një sistem të vlerësimit me pikë për lëndë, në varësi të natyrës së tyre), por nuk përmban asnjë kriter në lidhje me kohëzgjatjen e zgjidhjes së lëndëve.

Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit të kohës mesatare për zgjidhjen e lëndëve në këtë rregullore, do të mundësonte edhe monitorimin e punës së gjyqtarëve në lidhje me kohën e arsyeshme për përfundimin e lëndëve, siç parashihet monitorimi dhe masat që ndërmerren në rastet e mosrealizimit të normës. Në nenin 22 të kësaj Draft Rregulloreje (Monitorimi i zbatimit të normës) parashihet se në rastet e mos përmbushjes së normës kërkohet raport me shkrim nga gjyqtari, e nëse raporti nuk paraqitet me arsyet e mosrealizimit të normës, kryetari i gjykatës duhet të inicioj procedurë disiplinore. Ky do të ishte edhe një nga mekanizmat që KGJK do të mund të zbatonte për respektimin e standardit për gjykim në kohë të arsyeshme. Gjithashtu, edhe në Rregulloren Nr. 01/2021 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, derisa nuk ka kriteret mbi kohën e arsyeshme për zgjidhjen e lëndëve, nuk parashihet as vlerësimi i performancës në lidhje me këtë standard. Edhe kjo rregullore, duhet të ndryshohet (*pas krijimit të bazës normative që përcakton kohën mesatare për përfundimin e lëndëve*) dhe në kompetencë të Komisionit për vlerësim të performancës të përcaktohet edhe vlerësimi në lidhje me përfundimin e lëndëve brenda kohës së arsyeshme.

Kështu sipas të dhënave statistikore të KGJK-së të datës 30.06.2022, lëndë në pritje nga lëmia penale dhe civile janë 200.935 (dyqind mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) lëndë në total. Nga ky numër i përgjithshëm prej 200.935 lëndë:

- 19.367 janë në pritje prej 0 deri 1 muaj,
- 41.485 janë në pritje prej 2 deri 6 muaj;
- 44.941 janë në pritje prej 7 deri 12 muaj;
- 42.209 janë në pritje prej 13 deri 24 muaj;
- 10.933 lëndë janë në pritje prej 25 deri 30 muaj;
- 7.742 janë në pritje prej 31 deri 36 muaj
- dhe më shumë se 36 muaj janë në pritje 34.258 lëndë.

Gjithashtu, sipas raportit del se lëndë të vjetra në fund të vitit 2021 kanë qenë 49110 lëndë, ndërsa me 30.06.2022 ky numër i lëndëve të vjetra është 52933. Duke u bazuar në këto të dhëna, në fund të periudhës 30.06.2022 krahasuar me fundin e vitit 2021, është rritur numri i lëndëve të vjetra për 7,8%.

Të dhënat e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK):

Sipas praktikës së GJEDNJ, në rastet që zhvillohen në procedurë penale, është me rëndësi që kërkesat e nenit 6 të KEDNJ të zbatohen nga faza e hetimit, madje edhe në lidhje me veprimet paragjyqësore. Sipas GJEDNJ, në lidhje me procedurën penale, neni 6 gjen zbatim edhe në procedurat paragjyqësore (siç janë veprimet paraprake që ndërmerren para fillimit të procedurës penale, përfshirë veprimet e policisë), ku ky sqarim është dhënë duke argumentuar se: garancitë e parashikuara në Nenin 6 zbatohen jo vetëm në proceset gjyqësore, por gjithashtu edhe në fazat që i paraprinë procedurës penale dhe e pasojnë atë. Në çështjet penale garancitë aplikohen edhe në hetimet paragjyqësore të kryera nga policia, ndërsa përtej faktit se garancitë ofrohen nga momenti i ngritjes së aktakuzës si rregull, kushtet e tjera të nenit 6, sidomos ato të përmbajtura në parag.3, zbatohen edhe para se çështja të kalojë në gjykatë (Imbroscia kundër Zvicrës). Andaj, duke u bazuar në standardin e përcaktuar nga GJEDNJ se kërkesat e nenit 6 të Konventës duhet zbatuar edhe në fazën e hetimit është me rëndësi që për garantimin e të drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme në rastet penale, të analizohet edhe sistemi prokurorial (në lidhje me fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës në kuadër të procedurës penale).

Nga të dhënat e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) për vitin 2021 dhe gjashtëmujorin e I-rë të vitit 2022, vërehet se mbahen statistika të sakta sa i takon mesatares së lëndëve të pranuar, lëndëve në punë, lëndëve të zgjidhura nga prokurorët (sipas prokurorive dhe departamenteve) në raport me normën e përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit si dhe me Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2018 për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit, por nuk ka të dhëna tjera sa i takon kohës së zgjidhjes së lëndëve, përkatësisht kohëzgjatjes (mesatare) të hetimeve për raste penale. Sipas informatave të siguruara nga KPK, theksohet se zyra e statistikave nuk posedon të dhënat në lidhje me kohëzgjatjen e hetimeve për shkak të mënyrës së grumbullimit të të dhënave, e të njëjtat do të mund të mbahen pas funksionalizimit të Modulit për Statistika të SMIL-it.

Gjithashtu, edhe Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për 2021, ofron informacion të përgjithshëm për punën e Prokurorit të Shtetit. Sipas këtij raporti, Prokurori i Shtetit (PSH) gjatë vitit 2021 ka pasur në punë gjithsejtë 132069 kallëzime – lëndë penale. Nga ky numër i lëndëve: 80396 ose 60.87% janë të trashëguara/bartura si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake dhe 51673 ose 39.13% janë pranuar në punë gjatë vitit 2021. Gjatë vitit 2021: 50118 se 37.94% i lëndëve në punë gjatë vitit 2021, janë zgjidhur apo proceduar në organet kompetente, ndërsa 81951 ose 62.06% e të gjitha lëndëve në punë kanë mbetur pa u zgjidhur.

Raporti po ashtu përmban të dhëna edhe sa i takon efikasitetit në lidhje me zgjidhjen e lëndëve brenda vitit 2021, ku: 1555 kallëzime-lëndë penale janë zgjidhur, pra më pak se që janë pranuar gjatë periudhës raportuese (2021), apo 3,00% nga totali i pranuar. E kur i shtohet këtu edhe numri i lëndëve që janë të bartura nga vitet paraprake (që sipas raportit janë 80.396) del se

efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve është shumë më i vogël. Në këtë rast, duhet marrë në konsideratë edhe rritja e numrit të prokurorëve, që konsiderohet si një nga parakushtet e rëndësishme të efikasitetit të Prokurorit të Shtetit.

Nga analiza e këtyre të dhënave dhe dokumenteve tjera të Prokurorit të Shtetit dhe KPK-së, del se nuk ekziston asnjë mekanizëm i veçantë që do të përcaktonte kritere mbi kohën mesatare të zgjidhjes së lëndëve, në mënyrë që kjo të shërbente edhe si bazë e vlerësimit të performancës së prokurorëve. Andaj, në mënyrë të njëjtë si KGJK, edhe KPK duhet të krijoj një mekanizëm mbi përcaktimin e kohëzgjatjes (mesatare) së hetimeve nga prokurorët, si një nga kriteret e vlerësimit të performancës së tyre. Kjo do të ishte një nga masat në funksion të përfundimit të hetimeve në kohë dhe pa vonesa, si parakusht edhe i përfundimit të procesit penal brenda një kohe të arsyeshme. Ndërtimi i një mekanizmi të tillë do të krijonte bazën që nga prokurori të kërkohet arsyetim me shkrim në rastet kur ka vonesa në përfundimin e hetimeve, dhe në rast të kundërt edhe të iniciohet procedurë disiplinore.

Përveç kësaj, në sistemin prokurorial mbeten sfidë edhe disa aspekte, që cilësohen si parakushte të procesit të drejtë dhe përfundimit të rasteve në kohë, si: arsyetimi i vendimeve për fillimin dhe kohëzgjatjen e hetimeve (sidomos në rastet e paraburgimit), njoftimi me kohë i të pandehurit me akuzat, shfrytëzimi i procedurave alternative, etj.

Si mjet i rregullt juridik konsiderohet: Ankesa kundër aktgjykimit dhe Ankesa kundër aktvendimit, ndërsa si mjet i jashtëzakonshëm: Kërkesa për rishikimin e procedurës penale; Kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, përveç llojit të mjeteve juridike, në nenet 375-378 përcakton edhe “Rregullat e përgjithshme të procedurës ankimore” si edhe bazën/arsyen e paraqitjes së mjetit juridik në dispozitat vijuese, ku të njëjtat parashihen në mënyrë taksative. Por në asnjë dispozitë, nuk ka bazë që të paraqitet kërkesë, kundërshtim apo ankesë kundër zvarritjes së procedurës, përkatësisht shkëljes së të drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme. Andaj, si të tilla mjetet juridike në procedurë penale, nuk janë efikase sa i takon kësaj të drejte.

b) Lëndët e natyrës civile dhe administrative

Ligji Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, neni 12 parasheh juridiksionin e Gjykatës Themelore sipas lëndës. Paragrafi 1 i këtij neni përcakton që Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Lëndët gjyqësore të natyrës civile (kontestet juridiko-civile) trajtohen nga departamenti i përgjithshëm që vepron në selinë e secilës gjykatë themelore si dhe degë të gjykatës duke përfshirë edhe Gjykatën e Apelit. Në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm funksionojnë edhe tri (3) divizione, përkatësisht Divizioni Penal, Divizioni për Kundërvajtje dhe Divizioni Civil. Kontestet juridiko – civile (çështjet kontestimore, jo kontestimore, përmbarrimore dhe lëndët e dhunës në familje) trajtohen në Divizionin Civil.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale, të gjitha kontestet tregtare dhe konfliktet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare do të kalojnë në kompetencë të Gjykatës Komerciale, siç përcaktohet me këtë ligj. Dhomat e shkallës së parë të Gjykatës Komerciale

përbëhen nga katër (4) departamente të ndara, përfshirë Departamentin për Çështje Ekonomike, Departamentin Fiskal, Departamentin për Çështje Administrative dhe Departamentin e Përgjithshëm. Deri më tani rreth 8 mijë lëndë janë transferuar në këtë gjykatë. Megjithatë numri i gjyqtarëve duhet të jetë i pamjaftueshëm.

Divizioni civil përbëhet nga 107 gjyqtarë në të gjitha divizionet civile të Gjykatave Themelore të Kosovës¹⁷ ku ky numër është dukshëm më i vogël në krahasim me vitet e kaluara (vetëm në Gjykatën Themelore të Prishtinës numri i gjyqtarëve në vitin 2021 ka qenë tridhjetë e një (31) kurse për vitin 2022 numri i gjyqtarëve është njëzet e dy (22)). Shkak i zvogëlimit të numrit të gjyqtarëve janë transferimet e gjyqtarëve dhe avancimet në departamentin administrativ të gjykatave Themelore, gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Komerciale dhe këto pozita nuk janë plotësuar ende.

Në bazë të statistikave të KGJK-së numri i lëndëve të trashëguara shkon duke u rritur në vitin 2021 ndërkaq numri i lëndëve të pranuar është më i vogël në krahasim me vitin 2020. Megjithatë gjashtëmujori i parë i vitit 2021 i gjen gjykatat themelore të prishtinës me rreth 146 mijë lëndë të natyrës juridiko – civile të cilat duhet të trajtohen nga 107 gjyqtarë.

Shumica e gjyqtarëve të këtij divizioni i kanë mbi 1000 lëndë të cilat duhet trajtuar që e pamundëson gjyqtarin t'i përfundojë lëndët me kohë, dhe si rezultat vjen edhe deri tek shkelja e parimit të gjykimit brenda kohës së arsyeshme.¹⁸

Në vijim, në formë tabelare ofrohen të dhënat lidhur me numrin e lëndëve të natyrës civile:

Periudha raportuese 2021¹⁹						
Lëndët	lëndët e trashëguara	Lëndët e pranuar	Gjithsej në punë	Lëndët e zgjidhura gjatë periudhës raportuese	Lëndët e pazgjidhura gjatë periudhës raportuese	Mesatarja e kohëzgjatjes së lëndëve të zgjidhura
Kontestimore	84465	18635	103100	12280	90820	689 ditë
Jokontestimore	4805	1604	6409	1366	5043	357 ditë
Përmbartimore	23495	13173	36668	8294	28374	184 ditë
Gjithsej	112765	33412	146177	21940	124237	

Tabela 4: Numri i lëndëve të natyrës civile në vitin 2021

¹⁷ Raporti Gjashtëmujor i KGJK-së i vitit 2022, https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/31910_KGJK_Raporti_gjashtemujor_pare_2022.pdf

¹⁸ Intervistë me gjyqtarë të divizionit civil

¹⁹ KGJK, raportet statistikore 2021, 2020.

Periudha raportuese 2020						
Lëndët	lëndët e trashëguara	Lëndët e pranuar	Gjithsej në punë	Lëndët e zgjidhura gjatë periudhës raportuese	Lëndët e pazgjidhura gjatë periudhës raportuese	Mesatarja e kohëzgjatjes së lëndëve të zgjidhura
Kontestimore	55424	29319	84743	20329	64414	N/A
Jokontestimore	3444	2935	6379	2312	4067	N/A
Përmbare	164	6178	6342	439	5903	N/A
Gjithsej	59032	38432	97464	23080	74384	N/A

Tabela 5: Numri i lëndëve të natyrës civile në vitin 2020

Kohëzgjatja e një procesi gjyqësor është treguesi më i rëndësishëm për matjen e performancës së sistemeve gjyqësore. Sipas CEPEJ ka dy tregues të rëndësishëm në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore (si për çështjet civile, ashtu edhe për çështjet penale apo administrative): kohëzgjatjen faktike dhe kohëzgjatjen prospektive²⁰. Kohëzgjatja faktike mat periudhën kohore të kaluar nga data kur është çelur një çështje e re deri në datën kur është nxjerrë aktgjykimi. KGJK në raportet e saja statistikore ka nxjerrë mestaren e kohëzgjatjen së zgjidhjes së një lëndë duke aplikuar formulën e CEPEJ.²¹ Sipas të dhënave të KGJK-së, mesatarja e kohëzgjatjes së lëndëve të natyrës kontestimore është rreth (3) vite, mesatarja e kohëzgjatjes së lëndëve të natyrës jo kontestimore është mbi dy (2) vite, ndërsa mesatarja e kohëzgjatjes së lëndëve të natyrës përmbare është më pak se një (1) vit.²² Megjithatë edhe CEPEJ thekson se mesatarja e thjeshtë aritmetikore nuk e tregon qartë realitetin në sistemin gjyqësor²³. Pavarësisht mesatares së kalkuluar nga KGJK, divizioni civil ka një numër lëndësh që datojnë qysh prej vitit 2000 e për të cilat ende nuk është marrë vendim meritor. Në bazë të të dhënave të nxjerra nga gjyqtarët, trajtimi i një lëndë të natyrës civile brenda afatit tre - katër vjeçar ndodh shumë rrallë dhe konsiderohet si skenari më i mirë i mundshëm.²⁴ Tutje, sipas monitorimit të seancave gjyqësore nga organizatat e shoqërisë civile, ka një numër lëndësh kur seanca përgatitore është caktuar pas

²⁰ <https://rm.coe.int/komisioni-evropian-per-efikasitetin-e-drejtises-cepej-matja-e-cilesis/16807477ca>

²¹ Treguesi DT përcakton numrin e ditëve të nevojshme për një rast të pazgjidhur në pritje për t'u zgjidhur nga gjykata dhe përbën një të dhënë të mëtejshme se si e administron fluksin e çështjeve sistemi gjyqësor. Ky tregues krahason numrin e çështjeve të pazgjidhura gjatë periudhës nën vëzhgim dhe numrin e çështjeve të pazgjidhura në fund të periudhës nën vëzhgim. 365 pjesëtohet me numrin e çështjeve të zgjidhura pjesëtuar me numrin e çështjeve të pazgjidhura në fund, për të qenë në gjendje të shprehet me numrin e ditëve. Për shembull, llogaritja e kohëzgjatjes mesatare e 1.000 proceseve gjyqësore të zgjidhura brenda një viti nga një gjykatë e caktuar tregon se kohëzgjatja mesatare është një vit. Nëse shohim një zbatim të kohëzgjatjeve përkatëse dhe çështjet të marra në konsideratë në proceset e veçanta, do të shohim një gamë të konsiderueshme çështjesh të diskutuara dhe një përhapje të madhe të afateve.

²² Formula e CEPEJIT e përdorur nga KGJK për kalkulimin e mesatares së kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve

²³ Ibid.

²⁴ Intervistë me gjyqtarë të divizionit civil të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

dy viteve e aktgjykimi nuk ka përfunduar ende.²⁵ Ka raste kur padia është paraqitur në vitin 2007 ndërsa seanca përgatitore është caktuar në 2017.

Sa përket normës orientuese, gjyqtarët e divizionit civil janë të obliguar që brenda muajit të zgjidhin nga 27 lëndë, derisa brenda vitit, të njëjtit gjyqtarë duhet të zgjidhin nga 329 lëndë. Një numër i gjyqtarëve të këtij divizioni e tejkalojnë këtë normë por e cila nuk reflektohet në statistikat e KGJK-së.²⁶

Nga gjetjet e monitorimit të Organizatave të shoqërisë civile që vazhdimisht monitorojnë seancat gjyqësore tregojnë se procedurat gjyqësore civile zvarriten në pothuajse secilën fazë procedurale, që nga caktimi i seancës përgatitore, përgjigja në padi, shqyrtimi gjyqësor etj. Të gjitha këto shkelje në fund përbëjnë zvarritje të madhe të lëndëve civile, e që në disa raste është edhe me dekada. Një numër faktorësh kanë kontribuar në stërzgjatjen e lëndëve të natyrës civile, dhe si përfundim edhe shkeljen e parimit të gjykimit brenda kohës së arsyeshme: numri i madh i lëndëve të trashëguara dhe të pranuar në krahasim me numrin e gjyqtarëve, mungesa e bashkëpunorëve profesionalë, kthimi i lëndëve nga dy herë nga gjykata e Apelit për rivendosje tek gjykata e shkallës së parë (efekti ping-pong), shtyerja e senacave si pasojë e mosparaqitjes së palëve në seancë si dhe mungesës së gjyqtarëve.

Faktor i rëndësishëm i rritjes së numrit të padive civile është edhe mosvendosja për kërkesën pasusore juridike të palës së dëmtuar në procedurë penale. Sipas Kodit të Procedurës Penale, kërkesa pasurore juridike si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale vendoset me propozimin e personave të autorizuar në procedurën penale në qoftë se kjo nuk e zvarrit procedurën në mënyrë të konsiderueshme. Vërehet një tendencë pothuajse tek shumica e procedurave penale që gjykatat penale shmangin që të vendosin për kërkesën pasusore juridike edhe kur e kanë për obligim bazuar në Kodin e Procedurës Penale, duke i udhëzuar palët në kontest civil ndonëse Kodi i Procedurës penale e lejon këtë. Kjo praktikë e ka rënduar situatën duke akumuluar lëndë në kontesteve civile. Pothuajse në asnjë aktgjykim penal ku pala e dëmtuar udhëzohet në procedurë kontestimore nuk ka arsyetim përse është refuzuar të vendoset për kërkesën civilo-juridike në procedurë penale dhe gjyqtarët nuk japin asnjë lloj përgjegjësie për një shkelje të tillë të Kodit.

Situatë pothuajse të njëjtë kemi edhe në departamentin administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Edhe Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2021 thekson se Gjykata Themelore e Prishtinës ende vazhdon të përballet me numër të madh të lëndëve administrative (të trashëguara dhe të reja). “Backlogu” i rasteve të natyrës administrative në fund të Gushtit 2021 ka qenë 1993 lëndë.

Sipas Ligjit për Gjykatat, Departamenti për Çështje Administrative vepron në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili department gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe ka juridiksion për gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Me krijimin e gjykatës Komeriale, një numër i lëndëve që i takojnë divizionit administrativ - fiskal kanë kaluar tek kjo gjykatë. Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) është ligji bazë mbi të cilin zhvillohet një procedurë gjyqësore

²⁵ Drejtësia Civile, Instituti I Kosovës për Drejtësi (2019)

²⁶ Intervistë me gjyqtarë të divizionit civil

administrative. Momentalisht Projektligji i ri për Konfliktet Administrative (LKA) është duke u shqyrtuar në Kuvend.

Në këtë department janë nëntë (9) gjyqtarë dhe vetëm dy (2) bashkëpunëtorë juridik. Nëse e bëjmë krahasimin me divizionin civil, ky departament ka barrë më pak sa i përket trajtimit numrit të lëndëve të trashëguara dhe të pranuara.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për numrin e lëndëve për periudhën 2022 (gjashtëmuji i parë), 2021 dhe 2020 në departamentin administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës.²⁷ Numri i lëndëve administrative fiskale nuk është inkorporuar në tabela për shkak se një numër i tyre ka kaluar në Gjykatën Komerciale.

	Të trashëguara	Të pranuar gjatë periudhës raportuese	Gjithsej në punë	Të zgjidhura	Të pazgjidhura	Kohëzgjatja mesatare e kryerjes së lëndëve	Numri i gjyqtarëve
2022 (Gjashtë muji I)	6156	1499	7655	1290	6365	842.00 ditë	8
2021	6347	2816	9163	2951	6212	880.00 ditë	12
2020	6380	1905	8285	1947	6338	998.00 ditë	

Tabela 5: Numri i lëndëve të natyrës civile në vitin 2021

Sipas tabelës së mësipërme vërehet një trend i rritjes së numrit të lëndëve të pranuar ndërkaq mesatarja e kohëzgjatjes së zgjidhjes së lëndëve është shkurtuar në krahasim me vitin 2020 për rreth njëqind (100) ditë. Numri i gjyqtarëve gjatë vitit 2022 është ulur prej 12 në 8 gjyqtarë dhe kjo mund të ketë ndikuar edhe në mospërbushjen e normës së punës. Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese për vitin 2022 më të vjetra se dy (2) vite për periudhën gjashtëmuji 2022 janë 1657 lëndë, që është një indikator që tejzgjatja e procedurave gjyqësore në departamentin administrative po vazhdon të jetë shqetësuese. Si përfundim, mesatarja e zgjidhjes së një lënde të natyrës administrative është më shumë se dy vite.

Sipas të dhënave nga KGJK,²⁸ për periudhën gjashtë-mujore 2022, departamenti administrativ ka arritur të përmbushë normën e punës. Ndërkaq për periudhën raportuese 2021, gjyqtarët e departamentit administrative kanë arritur pothuajse të përmbushin normën e punës me 20.49 lëndë. Secili gjyqtar në këtë department ka përafërsisht rreth 600 lëndë në punë, që është një shumë i madh në krahasim me numrin e gjyqtarëve.

Tek departamenti administrativ, përpos ngarkesës me lëndë, është identifikuar problematike edhe mungesa e arsytimit të mjaftueshme në Aktgjykim në mënyrë që palët ta kenë të qartë se pse është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Aktgjykimet e rasteve të monitoruara nga

²⁷ Raportet e KGJK-së 2020, 2021, 2022, https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/31910_KGJK_Raporti_gjashtemujor_pare_2022.pdf

²⁸ Raporti statistikor i KGJK-së për gjashtëmuji i parë 2022

organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkomëbtare (OSCE)²⁹ tregojnë se në shumë raste gjykata nuk jep një arsyetim konkret dhe në rekomandime konkrete për organin administrativ që do të shqyrtojë rekomandimin e gjykatës kur rasti kthehet në rivendosje tek të njëjtit që si pasojë vjen edhe deri tek zvarritjet e lëndëve të natyrës administrative.³⁰

Poashtu, tendenca e gjyqtarëve të departamentit administrativ që të mos vendosin në mënyrë meritore për rastin por duke e dërguar fillimisht çështjen për rivendosje tek organi administrativ shkakton vonesa në zgjidhjen e rasteve të natyrës administrative.³¹

Numrit të madh të padive administrative i kanë kontribuar edhe vendimet jo-ligjore të organeve administrative.³² Në një numër të konsiderueshëm të rasteve vendimet administrative paraqesin arsyetim të dobët ose mos-arsyetim.

c) Trajtimi i lëndëve nga Gjykata e Apelit (efekti ping-pong)

Sipas raporteve të shoqërisë civile³³, shqetësimi më i ngutshëm që ka një pasojë në vonimin e vendimeve për çështjet ka të bëjë me të ashtuquajturin “efektin ping pong” midis organeve administrative dhe gjykatave, sipas të cilit ankesat drejtuar gjykatave kundër vendimeve të organeve administrative nuk vendosen në gjykatë në mënyrë meritore, por të njëjtat ankesa i kthehen organeve administrative disa herë për shqyrtim dhe vendim. Gjithashtu në 30-40% të rasteve Gjykata e Apelit nuk vendos në mënyrë meritore për çështjen por të njëjtën e kthen për rivendosje tek gjykata e shkallës së parë (në një numër të rasteve edhe nga dy herë), praktikë kjo që e zgjat kohën e zgjidhjes së rastit për palën.

Sipas mandatit ligjor, Gjykata e Apelit është gjykatë e shkallës së dytë me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës. Në kuadër të kësaj gjykate funksionojnë gjashtë departamente, përkatësisht: Departamenti i Përgjithshëm, Departamentin për Krime të Rënda, Departamentin për Çështje Ekonomike, Departamentin për Çështje Administrative, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Momentalisht, Gjykata e Apelit ka 52 gjyqtarë dhe 82 staf mbështetës- shërbyes civil.

Më poshtë janë paraqitur tabelat lidhur me ngarkesën me lëndë nga gjykata e Apelit për lëndët e natyrës penale, civile dhe administrative:

	Lëndët e trashëguara	Lëndët e pranuar	Gjithsej në punë	Lëndët e zgjidhura	Lëndët e pazgjidhura	Numri i gjyqtarëve
2021	756	7253	8009	7162	847	17
2020	743	5914	6657	5901	756	

Ngarkesa me lëndë të natyrës penale 2021, 2020 bazuar në raportet vjetore të KGJK-së

²⁹ <https://www.osce.org/files/f/documents/8/b/24638.pdf>

³⁰ IKD, Drejtësia Administrative

³¹ Intervistë me Avokatë, Raportet e monitorimit të seancave gjyqësore: IKD: Drejtësia Administrative

³² Intervistë me gjyqtarë të departamentit administrativ.

³³ Mjetet efektive juridike në Drejtësinë Administrative, Instituti i Kosovës për Drejtësi, shtator 2017

	Lëndët e trashëguara	Lëndët e pranuar	Gjithsej në punë	Lëndët e zgjidhura	Lëndët e pazgjidhura	Numri i gjyqtarëve
Gjashtë-mujori i parë i 2022	13061	4080	17141	4270	12871	28
2021	9039	11019	20058	6997	13061	24
2020	9916	6,599	16515	7,476	903	

Ngarkesa me lëndë të natyrës civile për periudhën 2022, 2021, 2020 bazuar në raportet vjetore të KGJK-së

	Lëndët e trashëguara	Lëndët e pranuar	Gjithsej në punë	Lëndët e zgjidhura	Lëndët e pazgjidhura	Numri i gjyqtarëve
Gjashtë-mujori i parë i 2022	1024	528	1552	469	1083	3
2021	721	1180	1901	877	1024	3
2020	544	797	1341	620	721	

Ngarkesa me lëndë të natyrës administrative për periudhën 2022, 2021, 2020 bazuar në raportet vjetore të KGJK-së

Sipas të dhënave të KGJK-së të pasqyruara në tabelat më lartë, numri i lëndëve të pranuar është vazhdimisht në rritje, e po ashtu ka rritje edhe të numrit të gjyqtarëve gjë që bën të qëndrojë më mirë sa i përket plotësimit të normës dhe zgjidhjes së lëndëve. Megjithatë KGJK nuk ka ofruar të dhëna sa i përket mesatares së zgjidhjes së një lënde nga Gjykata e Apelit e gjithashtu mungojnë të dhëna edhe sa i përket mënyrës së zgjidhjes së rasteve nga kjo gjykatë. Sipas nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, midis tjerash, gjykata e Apelit e ka poashtu kompetencën të vendosë meritorisht për çështjen, dhe aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë ta ndryshojë. Nëse do të aplikohet kjo praktikë, dhe vetëm në raste të domosdoshme Gjykata e Apelit ta kthejë lëndën për rivendosje, koha e zgjidhjes së një rasti gjyqësor do të zvogëlohet dukshëm. Në një numër prej këtyre rasteve, ka lëndë që kthehen edhe për çështje shumë të vogla e që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale për kthimin e lëndëve për rivendosje.³⁴

³⁴ Raportet e monitorimit të organiztave të shoqërisë civile, IKD: Drejtësia në shkallë të dytë, analizimi I aktgjykimeve të publikuara në faqen zyrtare të KGJK-së

Siç u tha më lartë numri i madh i lëndëve në raport me numrin e vogël të gjyqtarëve, parregullsitë gjatë procedurave gjyqësore, mungesa e arsytimit të aktgjykimeve janë faktorë kontribues në zvarritjen e procedurave dhe shkeljen e parimit të gjykimit brenda kohës së arsyeshme.

Kalkulimi i kohës së zgjidhjes së lëndëve të natyrës civile dhe administrative

Më lartë u theksua se KGJK ka një formulë të veçantë që e aplikon për caktimin e mesatares së kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore. Kohëzgjatja e gjithmbarshme e procedurave gjyqësore përfshinë dy elemente: momenti i fillimit të periudhës (Dies a quo) dhe momenti i përfundimit të periudhës (Dies ad quem). Këto momente mund të dallojnë për procedurat penale dhe civile. Për sa i përket pikës së fillimit të periudhës përkatëse, koha normalisht fillon të rrjedhë që nga momenti kur padia është ngritur përpara gjykatës kompetente³⁵ përveç nëse një kërkesë në një autoritet administrativ është një parakusht për ngritjen e procedurës gjyqësore, në të cilin rast periudha mund të përfshijë procedurën e detyrueshme paraprake administrative³⁶

Tek procedurat gjyqësore të natyrës juridiko-civile kohëzgjatja e procedurës kalkulohet nga momenti i paraqitjes së ankesës apo padisë në gjykatë.³⁷ : kur procedurat penale përfshijnë edhe padi civile të cilat nuk janë trajtuar në procedurë penale dhe pala është udhëzuar që të bëjë parashtrimin e kërkesës pasurore juridike, pika e fillimit përcaktohet në datën e paraqitjes së padisë civile në procedurë penale.³⁸

Ndërkaq tek rastet e natyrës administrative në të cilat palë janë organet administrative mund të merret parasysh edhe faza paraprake (paragjyqësore). Kur ligji rregullon se për zgjidhjen e një çështjeje duhet të shfrytëzohen rrugët administrative, kohëzgjatja e gjithmbarshme e procedurave kalkulohet nga data e paraqitjes së ankesës për zgjidhje të kontestit pranë organeve administrative.³⁹

Në parim kohëzgjatja e procedurës përfundon në ditën kur nxirret vendimi për zgjidhjen e kontestit, që është momenti kur akti përfundimtar i gjykatës merr formë të prerë. Për sa i përket përfundimit të periudhës, ajo zakonisht mbulon të gjithë procedurën në fjalë, duke përfshirë procedurën përpara gjykatës së shkallës së dytë.⁴⁰ Prandaj, koha e arsyeshme përfshin të gjitha fazat e procedurës ligjore që synon zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke mos përjashtuar fazat pasuese në gjykimin në themel që si dhe vendimin përfundimtar e poashtu edhe vendimin për kosto dhe shpenzimeve të procedurës. Momenti i përfundimit të kohëzgjatjes së një aktgjykimi në disa raste konsiderohet edhe momenti kur është ekzekutuar i njëjti. Prandaj, ekzekutimi i një

³⁵ Poiss kundër Austrisë, 1987, § 50; Bock kundër Gjermanisë, 1989, § 35

³⁶ Kress v. France [GC], 2001, § 90;

³⁷ Portington kundër Greqisë (Nr. 109/1997/893/1105), §20

³⁸ Casciaroli kundër Italisë (Nr. 1973/86), §16 Tomasi kundër Francës (Nr. 11973/86), §124

³⁹ Siermiński kundër Polonisë (Nr. 53339/09), § 65

⁴⁰ (König v. Germany, 1978, § 98

vendimi të dhënë nga çdo gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse të procedimit për qëllime të kalkulimit të kohëzgjatjes së procedurës civile.⁴¹

1.4. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për shkeljen e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (gjykimi brenda kohës së arsyeshme)

Gjykimi brenda kohës së arsyeshme hyn në kuadër të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.⁴² Çdo çështje gjyqësore e cila tejkalon kohën e arsyeshme të gjykimit do të duhej të vërtetohej nga Gjykata Kushtetuese. Kosova nuk është shtet anëtar i Këshillit të Evropës (KE) dhe prandaj nuk është palë kontraktuese në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Megjithatë, Kosova ka dispozita kushtetuese të cilat përcaktojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare, të cilat përfshijnë edhe parimin e gjykimin brenda kohës së arsyeshme të paraparë me nenin 6 të KEDNJ-së. Neni 22 i Kushtetutës përcakton se të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me KEDNJ, garantohen me Kushtetutë dhe zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.⁴³ Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.⁴⁴

Sipas nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kërkesa për shkelje të të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme (neni 6 Konventës) parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Në bazë të këtij neni, vendimi gjyqësor rezulton që të jetë parashkusht që pala të fitojë të drejtën të bëjë kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese për shkelje të së drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, në bazë të praktikës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, mjeti juridik duhet të jetë efektiv dhe i disponueshëm.⁴⁵ Të drejtat e njeriut janë ato të parapara me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të cilën Kushtetuta e Kosovës e ka për obligim ta zbatojë. Këto të drejta duhet të kenë mbrojtje gjyqësore. Mbrojtja gjyqësore realizohet sipas parimeve të përcaktuara me nenin 6 të Konventës. Neni 32 i Kushtetutës [E Drejta për Mjete Juridike] thekson: "Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat çenojnë të drejtat ose interesat e saj në mënyrën e përcaktuar me Ligj". Kur një sistem gjyqësor me mosveprim nuk e përmbush

⁴¹ Martins Moreira v. Portugal, 1988, § 44; Di Pede v. Italy, 1996, § 24

⁴² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 71

⁴³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 113, paragrafi 7 dhe neni 47 Ligji për Gjykatën Kushtetuese

⁴⁴ Neni 47, Ligji për Gjykatën Kushtetuese

⁴⁵ Rasti Latak v. Poland dhe Lominski v. Poland

nenin 6 të Konventës (gjykimin brenda kohës së arsyeshme) pretendohen se janë plotësuar kushtet që Gjykata Kushtetuese e cila bën vlerësimin e ekzistimit të shkëljes së kësaj të drejte të marrë vendim meritor. Analogji e kësaj është heshtja administrative tek konfliktet administrative. Rrethi vicioz i sanksionuar me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese (neni 49) që parasheh shterrjen e mjetit juridik në gjykata të rregullta në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të vendosë në mënyrë meritorë për çështjen do të stimulojë vazhdimin e shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e pushtetit gjyqësor.

Megjithatë në praktikë ka patur raste kur Gjykata Kushtetuese ka trajtuar lëndët edhe pa shteruar mjetet ligjore në fazat e mëparshme⁴⁶. Në aktgjykimin e Rastit KI41/12 (Rasti i Diana Kastriotit), gjykata në arsyestimin e saj konstanton se "Rregullimi i shterimit të mjeteve juridike bazohet në supozimin e pasqyruar në nenin 13 të KEDNJ (me të cilin ka lidhje të ngushtë) se ekziston një mjet efektiv juridik në dispozicion për sa i perket shkeljes së supozuar të të drejtave të individit të parapara me Konventë. Legjisalcioni kombëtar nuk parasheh masa për adresimin e mosveprimit të institucioneve pergjegjese në ato raste kur janë të detyruara të veprojnë. Prandaj, kjo pengon parashtruesit e kërkesës në realizimin e të drejtave të tyre për mjete efektive juridike, të parapara me nenin 32 e me nenin 54 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së. Bazuar në arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese, legjislacioni kombëtar nuk parasheh mjete juridike efektive për të adresuar mosveprimin e insitucioneve gjyqësore andaj parashkushti që të shtjerren mjetet juridike në mënyrë që pala të fitojë të drejtën të bëjë kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese nuk mund të vlejë.

Gjykata Kushtetuese rikujton në Rastin KI06/10 Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, se sipas praktikës së mirëfilltë gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës duhet të shterojnë mjetet juridike vendëse që janë në dispozicion dhe që janë efektive. Për më tepër, ky rregull duhet të zbatohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar. GJEDNJ-ja, më tej, pranoi që rregulli i shterjes së mjeteve juridike nuk është as absolut e as në gjendje të zbatohet në mënyrë automatike. Me rastin e shqyrtimit, nëse ai është zbatuar, është me rëndësi të merren parasysh rrethanat e posaçme të secilit rast individual. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se ai duhet të ketë parasysh jo vetëm ekzistimin e mjeteve zyrtare juridike në sistemin e vendit në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik në të cilin veprojnë, si dhe rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës.⁴⁷

Po ashtu, Gjykata Kushtetuese ka vendosur mbi rastin KI19/21 në gusht të vitit 2022 në të cilin ka konstatuar shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor siç garantohet me Kushtetutë.⁴⁸

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.⁴⁹ Sa i përket kompensimit, vendimet e Gjykatës

⁴⁶ T.K. kundër Radio dhe Televizionit të Kosovës dhe Korporatës Energjetike të Kosovës, Kërkesa Nr. KI 11/09, datë 16 tetor 2009 dhe V.B. kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, Kërkesa Nr. KI 06/10, datë 30 tetor 2010

⁴⁷ Për më shumë: Aktgjykimi i GJEDNJ-së në rastin Akdivar kundër Turqisë)

⁴⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI19/21: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2022/08/ki_19_21_agj_shq.pdf

⁴⁹ Neni 116 i Kushtetutës së Kosovës

Kushtetuese kanë karakter deklarativ e konstataues, pra konstantojnë se ka patur shkelje të nenit 6 të Konventës, dhe nuk përcaktojnë masat e nevojshme për të riparuar shkeljen, përfshirë këtu kompensimin e palës për dëmin e pësuar siç ndodh me Gjykatën e Strasburgut. Në rastin konkret, pala në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese e fiton të drejtën të bëjë padi për kompensim të dëmit përpara Gjykatës Themelore, ku mund të vijmë prapë tek në një situatë të zvarritjes së procedurës. Prandaj, efekti i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk ofron satisfaksion për palën për faktin se e njëjta duhet të presë për vendimin e Gjykatës Themelore. Në anën tjetër duke qenë se Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, palët nuk mund t'i drejtohen Gjykatës Evropiane të Drejtësisë për pretendime se i'u është shkelur e drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Institucionet e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës duhet t'i kushtojnë shumë rëndësi kësaj jurisprudence, e cila edhe obligon të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, në rastin konkret sistemin gjyqësor.

1.4. Standardet relevante ndërkombëtare

Për qëllime të hartimit të këtij Koncept Dokumenti janë konsultuar një varg instrumentesh Ndërkombëtare lidhur me të drejtën e gjyqimit brenda kohës së arsyeshme duke përfshirë standardet e GJEDNJ dhe disa nga praktikatat e shteteve evropiane lidhur me këtë të drejtë.

1.4.1. Standardet e Jurisprudencës të GJEDNJ

Koncepti i afatit të arsyeshëm kohor sipas GJEDNJ pasqyron një ekuilibër optimal midis gjatësisë dhe cilësisë së shqyrtimit të një çështjeje. Një ekzaminim gjithëpërfshirës dhe i plotë nga një gjykatë i rrethanave të çështjes, në përputhje me të drejtat procedurale të palëve, kërkon gjithmonë kohë. Për të siguruar ekuilibrin e mësipërm, koncepti i afatit të arsyeshëm bazohet në një qasje individuale në çdo çështje. Kjo qasje do të bazohet në kritere të tilla si:

- kompleksiteti i çështjes
- sjellja e palëve
- veprimet e gjykatës dhe autoriteteve të tjera shtetërore të përfshira në proces
- rëndësia e çështjes për personat në fjalë (paditësin/të pandehurin)

Vlerësimi i kohëzgjatjes së procedurave për qëllime të një kohe të arsyeshme është shumë individual dhe bazohet në rrethanat e një rasti të caktuar. E njëjta kohëzgjatje e procedurave mund të konsiderohet si e arsyeshme në një rast dhe e paarsyeshme në një rast tjetër. Gjykata përdor standarde të ndryshme të shqyrtimit në rastet që përfshijnë një problem strukturor të paarsyeshëm vonesash në disa sisteme kombëtare. Nëse problemi është strukturor dhe i vazhdueshëm, Gjykata zbaton një standard më të ulët të provës, duke mos hyrë në shqyrtim të hollësishëm, veçanërisht kur mungesa e mjeteve juridike të brendshme efektive kundër shkeljeve ishte vendosur në të kaluarën nga praktika gjyqësore e Gjykatës.

a) Afati i arsyeshëm dhe efikasiteti i organizimit gjyqësor

GJEDNJ e konsideron kohëzgjatjen e tepërt të procedurës gjyqësore si një tregues të funksionimit të dobët të gjyqësorit. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës* (Nr. 8737/79), KEDNJ vendos një detyrë për shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemin e tyre ligjor, në mënyrë të tillë që të lejojnë gjykatat të përmbushin kërkesat e Nenit 6 § 1 KEDNJ, duke përfshirë atë të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor. Shteti mban përgjegjësi jo vetëm për çdo vonesë të panevojshme të proceseve. Detyra e tij është gjithashtu të përmirësojë situatën e gjyqësorit ose ta rregullojë atë në përputhje me rrethanat, për të përballuar backlogun dhe rastet e përsëritura. Shteti gjithashtu, mban përgjegjësi për të gjitha gabimet në organizimin e gjyqësorit, që kontribuojnë në zvarritje të panevojshme të procedurave. Në këtë kontekst, backlogu nëpër gjykata nuk përbën një justifikim valid për çlirimin nga përgjegjësia e shteteve për zvarritjen totale të procedurave. Në përputhje me parimin e subsidiaritetit të GJEDNJ-së, çështja e zgjatjes së tepërt të procedurave duhet të trajtohet në radhë të parë nga gjykatat vendase.

b) Ku dhe kur zbatohet standardi i afatit të arsyeshëm kohor

Sipas nenit 6 § 1 KEDNJ, e drejta për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor mund të zbatohet në lidhje me shqyrtimin e të drejtave dhe detyrimeve civile të një personi ose të një akuze penale kundër një personi në një proces gjyqësor.

Koncepti i një çështjeje civile interpretohet shumë gjerësisht. Kjo mbulon të gjitha procedurat, rezultati i të cilave është vendimtare për të drejtat dhe detyrimet private dhe përfshin tërësinë e asaj që përcakton ligji kontinental si e drejta private, pavarësisht nga ligji që rregullon një çështje të caktuar – civile, tregtare, administrative, etj. – ose autoriteti me juridiksion për të zgjidhur mosmarrëveshjen – qofshin gjykatat civile apo penale, gjykatat administrative, gjykatat kushtetuese, gjykatat profesionale, apo edhe organet administrative. Kështu, rastet civile përfshijnë mosmarrëveshjet në lidhje me statusin e individëve, ligjin familjar, pronën private, etj. Në përgjithësi, faktori përcaktues është nëse veprimet kane pasoja financiare. Nëse po, procedura konsiderohet të jetë një çështje civile. Sfera e procedurave në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile është zgjeruar kështu në mënyrë të konsiderueshme për t'u shtrirë në një shumëllojshmëri mosmarrëveshjesh. Natyra monetare e një mosmarrëveshjeje, për shembull, ka bërë të mundur të klasifikohet si një proces gjyqësor civil, një proces i cili, në të drejtën e brendshme, do të hynte në të drejtën publike. Kështu, neni 6 është i zbatueshëm për mosmarrëveshjet ndërmjet individëve privatë dhe një autoriteti publik – pavarësisht nëse ky i fundit vepron si individ privat ose si depozitar i autoritetit publik – nëse procedurat administrative e përfshira ndikojnë në ushtrimin e të drejtave pronësore, si me procedurat që kanë të bëjnë me shpronësimin, parablerjen, lejen e planifikimit, një mosmarrëveshje mbi një plan zhvillimi që rregullon ndërtimin, konsolidimin e tokës, mbrojtjen e mjedisit, etj.

Në çështje penale GJEDNJ zbaton një koncept autonom të asaj se çfarë kuptohet me termin “akuzë penale”. Në çështjen *Engel dhe të tjerët kundër Holandës* (Nr. 5100/71 et al.) GJEDNJ formuloi për herë të parë kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet nëse kemi të bëjmë me një akuzë penale. Këto kritere u zhvilluan më tej në çështjen *Öztürk kundër Gjermanisë* (Nr. 8544/79). Kriteret relevante për të përcaktuar nëse një rast është penal janë, nga njëra anë, natyra e shkeljes – pra, shkelja e një rregulli të përgjithshëm, qëllimi i të cilit është njëkohësisht parandalues dhe ndëshkues – ose, nga ana tjetër, lloji dhe masa e dënimit. Në bazë të këtyre kritereve GJEDNJ përdor termin “akuzë penale” në kuptimin e përgjithshëm, duke përfshirë:

- kundërvajtje disiplinore (*Engel dhe të tjerët kundër Holandës*, Nr. 5100/71 et al., §§84–85)
- çështje doganore (*Salabiaku kundër Francës*, Nr. 10519/83, §24)
- çështje tatimore (*Bendenoun kundër Francës*, Nr. 12547/86), §47)
- kundërvajtjet administrative (*Öztürk kundër Gjermanisë*, Nr. 8544/79, §§46–56)

Për më tepër, për shkak të interpretimit të gjerë nga GJEDNJ, garancitë e nenit 6 të Konventës shtrihen edhe në:

- procedurat kushtetuese (*Ruiz-Mateos kundër Spanjës*, Nr. 12952/87, §§31–32)
- marrëdhëniet juridike në fushën e veprimtarive hetimore (*Vanyan kundër Rusisë*, Nr. 53203/99, §§43–50; *Khudobin kundër Rusisë*, Nr. 59696/00, §129; *Bykov kundër Rusisë* (Dhoma e Madhe), Nr. 4378/02, §§94–105)

c) Periudha e arsyeshme

Në çështje civile, në përgjithësi, periudha llogaritet që nga momenti i paraqitjes së një ankese ose pretendimi në gjykatë (*Portington kundër Greqisë*, Nr. 109/1997/893/1105, §20). Mund të ndodhë që, në rrethana të caktuara, në çështjet civile periudha mund të fillojë edhe para paraqitjes së padisë pranë gjykatës së cilës i drejtohet paditësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (*Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 4451/70, §32). Për shembull, kur ligji parashikon që mjete juridik do të përdoret për të zgjidhur paraprakisht një mosmarrëveshje me mjete administrative, koha totale e procedimit llogaritet nga dita kur është paraqitur ankesa pranë autoritetit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Një tjetër shembull është rasti kur procedura penale përmban një padi civile, që nuk është shqyrtuar në procedimin penal dhe paditësi ankohet në një gjykatë civile. Në këto raste, pikënisja përcaktohet nga data e paraqitjes së padisë civile në procedurën penale.

Në çështje penale periudha fillon me ngritjen e aktakuzës. Si rregull, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, termi 'akuzë' në përgjithësi mund të përkufizohet si një njoftim zyrtar, i dhënë një individ nga autoriteti kompetent, i një pretendimi se ajo ose ai ka kryer një vepër penale. Megjithatë, në disa raste, akuza mund të marrë formën e masave të tjera të cilat mbartin

nënkuptimin e një pretendimi të tillë dhe që po ashtu ndikojnë ndjeshëm në situatën e të dyshuarit (Foti dhe të tjerët kundër Italisë, Nr. 7604/76 etj., §52; Corigliano kundër Italisë, Nr. 8304/78, §34).

Në përgjithësi, periudha që duhet të merret parasysh përfundon si në çështje penale ashtu dhe në ato civile me vendimin përfundimtar, ndaj të cilit nuk mund të ketë më ankesë. Kjo varion nga një vend në tjetrin dhe varet nga jurisdiksioni i çdo vendi dhe nga rrethanat e çështjes.

d) Mjetet efektive

Në çështjen *Kudla kundër Polonisë (Nr. 30210/96)* GJEDNJ-ja vendosi ekzistencën e një lidhjeje sistemike ndërmjet të drejtës për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor në nenin 6 § 1 të KEDNJ dhe të drejtës për një mjet juridik efektiv në nenin 13 KEDNJ:

156. Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme, GJEDNJ konsideron se interpretimi i drejtë i nenit 13 është se ajo dispozitë garanton një mjet efektiv para një autoriteti kombëtar për një shkelje të supozuar të së drejtës të garantuar nga neni 6 § 1 për të dëgjuar një çështje brenda një kohe të arsyeshme.”

Ky qëndrim i GJEDNJ-së mbi marrëdhëniet ndërmjet nenit 6 § 1 dhe nenit 13 KEDNJ u konfirmua më tej në raste të tjera, si për shembull rasti *Lukenda kundër Sllovenisë (Nr. 23032/02)*:

87. Në rastin konkret, Qeveria nuk arriti të vërtetojë se një veprimi administrativ, një padi për dëmshpërblim, një kërkesë për mbikëqyrje ose ankimi kushtetues mund të konsiderohen si mjete efektive juridike (...). Për shembull, kur një individ ndërmerr një veprim administrativ me të cilin pretendon shkelje të së drejtës së tij/saj për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, nderkohë që procedurat në fjalë janë ende pezull, ai ose ajo mund të ketë pritshmerinë e arsyeshme që gjykata administrative të shqyrtojë thelbin e ankesës. Megjithatë, nëse procedura kryesore përfundon para se të ketë pasur kohë për ta bërë këtë, ajo e hedh poshtë veprimin. Së fundi, GJEDNJ konkludoi gjithashtu se tërësia e mjeteve juridike në rrethanat e këtyre rasteve nuk janë efektive.”

Dy lloje të mjeteve juridike janë të mundshme kundër shkeljes së standardit të arsyeshëm të kohës: parandaluese dhe kompensuese. Mekanizmat që kufizohen në kompensim janë normalisht të dobët dhe të pamjaftueshëm për t'u marrë me thelbin e problemit. Idealisht GJEDNJ kërkon një kombinim të të dy llojeve të mjeteve juridike, duke lejuar kështu gjetjen e një zgjidhjeje për problemin themelor të vonesave të tepruara. Si përfundim, mjeti juridik që mbron të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme duhet të jetë efektiv. Kjo do të thotë se gjykatat kombëtare mund të "korrigojnë thelbësisht" në favor të kërkuarit të tyre një proces gjyqësor tepër të gjatë.

1.4.2. Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ): Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (CEPEJ(2018)26)

CEPEJ zhvillon masa dhe mjete konkrete që synojnë politikëbërësit dhe praktikuesit gjyqësorë me qëllim që: Të analizojë funksionimin e sistemeve gjyqësore dhe të drejtojë politikat publike të drejtësisë, të ketë njohuri më të mira të kornizave kohore gjyqësore dhe të optimizojë menaxhimin e kohës gjyqësore, të promovojë cilësinë e shërbimit publik të drejtësisë, të lehtësojë zbatimin e standardeve evropiane në fushën e drejtësisë.

Sipas raportit të CEPEJ-it,⁵⁰ Gjykata duhet të merr parasysh disa kritere për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e procedurës është e arsyeshme si: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuarit, sjellja e autoriteteve kombëtare dhe çfarë është në rrezik për kërkuarin.

Kompleksiteti i çështjes dhe sjellja e kërkuarit mund të lirojnë shtetin nga përgjegjësia e tij nëse është tejkaluar një kohë e arsyeshme, me kusht që arsyet të jenë mjaft objektive për të mos i atribuuar shtetit, dhe autoritetet vendase, për më tepër, kanë treguar kujdes të mjaftueshëm.

Raste të caktuara, të cilat janë të një rëndësie të veçantë për aplikantët, konsiderohen si prioritet. Rastet “prioritet”përfshijnë:

- kontestet e punës,
- kompensim për viktimat e aksidenteve;
- rastet në të cilat aplikanti është ndaluar gjatë procedurës;
- rastet kur shëndeti i aplikantit është një çështje kritike ose kur mosha e aplikantit është një faktor që duhet marrë parasysh
- rastet që kanë të bëjnë me ruajtjen e jetës familjare, mosmarrëveshjet lidhur me detyrimet për ushqim dhe rastet që kanë të bëjnë më përgjithësisht me gjendjen civile të aplikantit;
- procedurat në lidhje me shkeljen e të drejtave absolute të garantuara nga Konventa (në veçanti Nenet 2, 3 dhe 4 të Konventës).

1.5. Praktikrat e shteteve evropiane

Disa vende kanë miratuar ligje dhe procedura të veçanta për të prezantuar një mjet juridik që adreson kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedurave. Kjo ka ndodhur si pasojë e vendimeve të njëpasnjëshme të GJEDNJ-së, e cila ka gjetur shkelje të afateve si dhe mungesën e mjeteve

⁵⁰ <https://rm.coe.int/cepej-2018-26-en-rapport-calvez-regis-en-length-of-court-proceedings-e/16808ffc7b>

efektive për të adresuar shkeljet në nivel kombëtar. Ky seksion paraqet një përshkrim të praktikave në Itali, Bullgari, Sllovaki dhe Kroaci.

a) Italia

Italia, si pasojë e numrit të lartë të ankesave dhe vendimeve të GJEDNJ-së në të cilat është konstatuar shkelje e nenit 6, miratoi Ligjin no 89/2001, të ashtuquajturin Akti Pinto.

Akti Pinto lejon çdo palë në procedurat penale, civile, administrative dhe tatimore të ankohet për shkeljen e afatit të arsyeshëm dhe për të marrë kompensim financiar nga një gjykatë vendase. Kompensimi llogaritet vetëm për periudhën që tejkalon periudhën e arsyeshme.⁵¹ Ankesa dhe kërkesa për kompensim i drejtohet gjykatave të apelit, të cilat duhet të vendosin brenda 4 mujave nga momenti i paraqitjes së kërkesës. Vendimi i Gjykatës së Apelit mund të ankimohet në Gjykatën e Kasacionit. Vendimi i formës së prerë bëhet i ekzekutueshëm menjëherë. Ligji lejon ankimet të bëhen ose brenda 6 muajve nga data kur procesi ka mbaruar ose kur procesi është në zhvillim e sipër. Së fundi Akti parashikon dhe një buxhet për kompensimin. Megjithatë, Ligji nuk parashikon asnjë masë për përshpejtimin e procedurës. Ky fakt është konsideruar si një mangësi e Aktit nga Komiteti i Ministrave të KiE.⁵² Gjithashtu, CEPEJ⁵³ ka vënë në dukje se mekanizmat që kufizohen në kompensim janë shumë të dobët dhe nuk i nxisin në mënyrë adekuate shtetet që të modifikojnë procesin e tyre operacional dhe ofrojnë kompensim vetëm *a posteriori* në rast të një shkeljeje të provuar në vend që të përpiqen të gjejnë një zgjidhje për problemin e vonesave.

GJEDNJ e ka testuar në shumë raste dhe në kontekste të ndryshme Aktin Pinto. Çështja që vlen për t'u përmendur këtu është *Scordino k. Italisë (no1) (No 36813/97)*.⁵⁴

Si pasojë e kritikave të shumta si nga Komiteti i Ministrave i KiE ashtu dhe nga GJEDNJ, Italia ndërromori disa ndryshime të njëpasnjëshme. Ndryshimi i fundit ka qenë i vitit 2012. Risitë e ndryshimeve përfshijnë dispozitat sipas të cilave qasja në mjetin juridik "Pinto" kushtëzohet nga përfundimi i procedurës kryesore dhe kompensimi u përjashtua ose u kufizua në disa raste. Sidoqoftë, natyra thjesht kompensuese e mjetit "Pinto" është mbajtur. Ndryshimet e bëra në Aktin Pinto nuk e kanë bindur GJEDNJ-në për efikasitetin e mjeteve juridike në raste të vecantë.⁵⁵

b) Bullgaria

⁵¹ <https://hudoc.echr.coe.int/app/conversion/pdf/?library=ECHR&id=001-72935&filename=001-72935.pdf&TID=thkbhnilzk>

⁵² Shih CM/Inf/DH(2004)23 dhe Interim Resolution ResDH(2005)114.

⁵³ (CEPEJ (2004) 19 Rev 2 § 6).

⁵⁴ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-72925%22%5D%7D>

⁵⁵ Shih *Petrella kundër Italisë, no. 24340/07*, vendim i vitit 2021, si një nga shembujt më të fundit në një seri të gjatë çështjesh të gjykuara nga GJEDNJ kundër Italisë.

Në vendimet pilot *Dimitrov dhe Hamanov kundër Bullgarisë (No 48059/06 2708/09)* dhe *Finger kundër Bullgarisë (No. 37346/05)*⁵⁶, GJEDNJ kërkoi që Bullgaria të miratonte mjete juridike për të shqyrtuar procedimet penale të stërzgjatura. Gjithashtu GJEDNJ kërkoi miratimin e një mjeti kompensues në rastet e procedurave të tejzgjatura penale, civile dhe administrative. Si rrjedhojë, në vitin 2012 Bullgaria miratoi ndryshime të Ligjit për Gjyqësorin të vitit 2007. Ndryshimet rezultuan në shtimin e një kapitulli të ri në Ligjin 2007, më saktësisht, kapitullin 3a i cili titullohet “*Shqyrtimi i kërkesave kundër shkeljeve të së drejtës për shqyrtim dhe përcaktimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm*”. Dispozitat e reja të prezantuara, pjesa më e madhe e të cilave hynë në fuqi më 1 tetor 2012. Këto ndryshime parashikojnë që kërkesat për kompensim në lidhje me tejzgjatjen e procedurave duhet t'i drejtohen Ministrit të Drejtësisë nëpërmjet Inspektoratit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (Inspektorati). Gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve, ministri (ose një person i autorizuar prej tij ose saj) ndihmohet nga një panel i përbërë nga një inspektor dhe dy ekspertë që punojnë në një njësi të veçantë të Inspektoratit. Afati kohor për shqyrtimin e aplikacioneve është gjashtë muaj. Procedura është pa pagesë për paditësit. Kërkesat duhet të drejtohen “kundër akteve, veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve gjyqësore”, duke cënuar të drejtën për të dëgjuar dhe vendosur një çështje brenda një kohe të arsyeshme. Nuk përjashtohet shqyrtimi i aplikimeve në lidhje me vonesat që nuk rrjedhin nga mosveprimi e gjyqtarëve ose zyrtarëve gjyqësorë, por, për shembull, nga mbingarkesa e sistemit gjyqësor në tërësi. Kriteret që duhet të merren parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimeve janë kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave, vonesat që i atribuohen autoriteteve, si dhe vonesat që i atribuohen aplikantit dhe përfaqësuesit të tij ([s]neni 60d(2)(5)). Thelbi i kërkesës dhe shumica e kompensimit duhet të përcaktohen në dritën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ. Kompensimi paguhet nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë. Më pas Ministria e Financave duhet të rikthejë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë fondet e paguara si kompensim çdo tremujor. Kompensimi nuk i kalon 10000 Leva (rreth 5000 Euro) për rast. Këshilli i Ministrave ka rritur buxhetin e gjyqësorit me 300,000 leva bullgare të destinuara për krijimin në Inspektorat të njësisë speciale që merret me aplikimet sipas kreut 3a të Ligjit 2007.

Paralelisht me ndryshimin e Ligjit 2007, u miratuan dhe ndryshime në Ligjin e Përgjegjësisë së Shtetit dhe Komunave për Dëmin i vitit 1988 (Ligji 1988), ku u shtua neni 2b, i cili titullohet “*Përgjegjësia e autoriteteve gjyqësore për shkelje të së drejtës për të shqyrtuar dhe vendosur çështjen brenda një afati të arsyeshëm*”. Neni i ri 7(2) parashikon që kërkesat për kompensim sipas nenit 2b duhet të ngrihen në gjykatën në rajonin e së cilës personi i dëmtuar ka adresën ose selinë aktuale. Një dispozitë tjetër e re, neni 8(2) parashikon që individët ose personat juridikë mund të ngrenë pretendime sipas nenit 2b(1) në lidhje me procedurat që kanë përfunduar vetëm nëse ata kanë shteruar tashmë procedurën administrative sipas Kapitullit 3a të Ligjit 2007, dhe ajo procedurë nuk ka rezultuar në zgjidhje.

Në çështjen *Valcheva dhe Abrashev kundër Bullgarisë (No 6194/11 34887/11)*, GJEDNJ vlerësoi se kuadri ligjor Bullgar është në përputhje me kërkesat dhe standardet e GJEDNJ-së. Gjykata

⁵⁶ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-104698%22%5D%7D>

vlerësoi faktin se sistemi Bullgar parashikonte dy procedura për kërkimin e kompensimit nga dëmi. Nëse procedura administrative nuk jepte zgjidhje, atëherë personi i intersuar mund t'i drejtohej gjykatave, ku brenda një kohe të shkurtër mund të kishte një vendim gjyqësor të ekzekutueshëm.⁵⁷ Gjithashtu gjykata vlerësoi se thelbi i kërkesës dhe shuma e kompensimi përcaktohen në dritën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

c) Sllovakia

Sllovakia është një nga vendet me një numër të madh vendimesh të GJEDNJ-së kundër saj në lidhje me shkeljen e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Deri në vitin 2002, kërkesat për kompensim në rastet e zvarritjes së proceseve gjyqësore bëheshin nëpërmjet Ligjit për Përgjegjësinë Shtetërore. Ky ligj ishte vlerësuar në shumë vendime nga GJEDNJ si joefektiv.⁵⁸ Megjithatë, mbas vendimit *Kudla kundër Polonisë (Nr. 30210/96)*, në vitin 2002 Sllovakia ndërmori ndryshime kushtetuese dhe ndryshoi Nenin 127 të Kushtetutës, i cili përcakton se Gjykata Kushtetuese do të vendosë për ankesat e paraqitura nga persona fizikë ose juridikë që pretendojnë shkelje të të drejtave ose lirive të tyre themelore ose të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të parashikuara në traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika Sllovaqe. Gjykata Kushtetuese, kur konstaton se një ankim është i justifikuar, merr vendim që të drejtat ose liritë e një personi janë shkelur si rezultat i një vendimi përfundimtar, me një masë të caktuar ose me ndërhyrje të tjera. Ajo anulon një vendim, masë ose ndërhyrje tjetër të tillë. Kur shkelja e konstatuar vjen si pasojë e mosveprimit, Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë autoritetin që ka shkelur të drejtat ose liritë në fjalë të ndër marrë veprimet e nevojshme. Në të njëjtën kohë, Gjykata Kushtetuese mund t'ia kthejë çështjen autoritetit përkatës për procedime të mëtejshme, të urdhërojë autoritetin përkatës që të përmbahet nga cenimi i të drejtave dhe lirive themelore ose, sipas rastit, të urdhërojë ata që kanë shkelur të drejtat ose liritë e përcaktuara për të rivendosur gjendjen ekzistuese para shkeljes. Në vendimin e saj për ankesën, Gjykata Kushtetuese mund t'i japë kompensim adekuat financiar personit të cilit i janë shkelur të drejtat.

Këto ndryshime kushtetuese u shoqëruan me ndryshime në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, i cili në Nenet 49-52 zbaton më në detaje dispozitat kushtetuese. Më konkretisht, në bazë të Nenit 50(3), një person që kërkon kompensim adekuat financiar duhet të specifikojë shumën dhe të shpjegojë arsyet për një kërkesë të tillë. Neni 56(3) parashikon se, kur konstatohet një shkelje e të drejtave ose lirive themelore, Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë autoritetin përgjegjës për shkeljen të vazhdojë në përputhje me rregullat përkatëse. Ajo gjithashtu mund t'ia kthejë çështjen autoritetit përkatës për procedime të mëtejshme, të ndalojë vazhdimin e shkeljes ose, sipas rastit, të urdhërojë rivendosjen e situatës para shkeljes. Sipas Nenit 56(4), Gjykata Kushtetuese mund të japë kompensim adekuat financiar për dëmin jomaterial për një person të cilit i janë shkelur të drejtat ose liritë. Neni 56(5) parashikon se autoriteti që ka shkelur të drejtat

⁵⁷ Në çështjen *Vokurka kundër Republikës Çeke, No 40552/02*, GJEDNJ vlerësoi sistemin Çek, i cili është i ngjashëm me sistemin Bullgar, si efektiv.

⁵⁸ Shih për shembull vendimet *J.K. kundër Sllovakisë, No. 38794/97* dhe *Havala kundër Sllovakisë, No. 47804/99*.

e një personi në këtë rast është i detyruar të paguajë dëmshpërblimin brenda dy muajve pasi vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka marrë formë të prerë.

Në vendimin *Andrasik dhe të tjerë kundër Sllovakisë (No 57984/00)*, GJEDNJ vlerësoi se ndryshimet e mësipërme përbënin mjet efektiv në kuptim të KEDNJ. Gjykata është e bindur se ankimi sipas nenit 127 të Kushtetutës, së bashku me dispozitat përkatëse të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, përbëjnë një mjet juridik efektiv i cili është në gjendje të parandalojë vazhdimin e shkeljes së pretenduar të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe të sigurojë kompensimin adekuat për çdo shkelje që ka ndodhur.

d) Kroacia

Në çështjen *Horvat kundër Kroacisë, No.51585/99*, GJEDNJ gjeti shkelje të të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Gjithashtu, korniza ligjore kroate në lidhje me mjetin efektiv për adresimin e vonesave në gjykimin e çështjeve u konsiderua si joefektive. Korniza ligjore e atëhershme konsistonte në Nenin 59(4) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese i cili përcaktonte se përjashtimisht, Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë një ankesë kushtetuese përpara se të shterojë mjetet e tjera juridike në dispozicion, nëse është e bindur se një akt i kontestuar ose mosveprimi brenda një afati të arsyeshëm, cenon rëndë të drejtat dhe liritë kushtetuese të një palë dhe se, nëse ai nuk vepron një palë rrezikon pasoja të rënda dhe të pariparueshme.

GJEDNJ konstatoi se procedurat në përputhje me nenin 59(4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese konsideroheshin si të nisura vetëm nëse Gjykata Kushtetuese, pas një shqyrtimi paraprak të ankesës, vendos ta pranonte atë. Kështu, megjithëse personi në fjalë mund të ankohej drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, nisja formale e procedimit varej nga gjykimi i kësaj të fundit. Për më tepër, që një palë të jetë në gjendje të paraqesë një ankesë kushtetuese në përputhje me këtë dispozitë, duhet të jenë plotësuar dy kushte kumulative. Së pari, të drejtat kushtetuese të kërkuesit duhej të cenoheshin rëndë nga fakti se asnjë vendim nuk ishte nxjerrë brenda një kohe të arsyeshme dhe, së dyti, duhej të kishte rrezik për pasoja të rënda dhe të pariparueshme për kërkuesin. Këto terma u konsideruan si shumë të gjerë që lenë hapësirë për interpretim jokonsistent dhe për rrjedhojë kjo krijonte pasiguri juridike.

Pas vendimit *Horvat*, Parlamenti kroat miratoi Ligjin për Ndryshimet e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili shtoi Nenin 59(a) që cili më vonë u bë neni 63 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Kjo dispozitë përcakton se Gjykata Kushtetuese e shqyrton padinë kushtetuese edhe para se të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike në rastet kur gjykata kompetente nuk ka vendosur në afat të arsyeshëm për padinë lidhur me të drejtat dhe detyrimet e parashtruesit të kërkesës ose për kallëzim penal kundër tij. Nëse ankesa kushtetuese pranohet, Gjykata Kushtetuese cakton afat në të cilin gjykata kompetente do të vendosë për çështjen në merita. Me vendim Gjykata Kushtetuese do t'i caktojë parashtruesit kompensim adekuat për shkeljen e konstatuar lidhur me

të drejtat e tij kushtetuese. Kompensimi paguhet nga Buxheti i Shtetit në afat prej tre muaj nga data kur pala ka paraqitur kërkesën për pagesën e saj.

Në vendimin *Slavicek kundër Kroacisë, No 20862/02*, GJEDNJ vërejti se kjo dispozitë e re ka hequr pengesat që ishin vendimtare kur Gjykata konstatoi se neni 59(4) i mëparshëm nuk përmbushte të gjitha kërkesat për të përfaqësuar një mjet efektiv në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave. Sipas GJEDNJ-së, formulimi i nenit 63 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese është i qartë dhe tregon se ai është krijuar në mënyrë specifike për të trajtuar çështjen e zgjatjes së tepërt të procedurat para autoriteteve vendase. Sipas ligjit të ri, kushdo që çmon se procedimi për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose një kallëzim penal ndaj tij nuk ka përfunduar brenda një afati të arsyeshëm, mund të bëjë ankim kushtetues. Gjykata Kushtetuese duhet ta shqyrtojë një ankesë të tillë dhe nëse e gjen të bazuar, duhet të caktojë një afat për vendosjen e çështjes në themel, si dhe të japë dëmshpërblim për zgjatjen e tepërt të procesit. Gjykata vlerëson se ky është një mjet juridik në përputhje me Nenin 13 KEDNJ.

Kapitulli 2: Synimet dhe objektivat

Në Kapitullin 1 është përkufizuar problemi kryesor, shkaqet dhe efektet e tij. Gjithashtu janë elaboruar politikat, legjislacioni relevant, standardet ndërkombëtare dhe përvojat e shteteve tjera. Ky kapitull përcakton objektivat që synohen të arrihen përmes kësaj politike.

Objektivi strategjik i kësaj politike është zbatimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor dhe rritja e besimit qytetar në drejtësi.

Qëllimi i kësaj politike është realizimi e të drejtave civile duke përfshirë të drejtën e gjyqimit brenda afatit të arsyeshëm kohor siç garantohet me Kushtetutën e Kosovës dhe Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Figure 2: Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
2.2. Sundimi i ligjit 2.2.1 Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë 2.2.2 Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025
3.1. Funksionimi i gjyqësorit Nevoja për rritje të profesionalizmit dhe kompetencës ¹ 3.2. Drejtësia penale 4.1. Fuqizimi i sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial 4.1.1. Ngritja e llogaridhënies së sistemit gjyqësor dhe prokurorial 4.1.2. Ngritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial 4.1.3. Ngritja e profesionalizmit dhe kompetencës së personelit gjyqësor dhe prokurorial 4.2. Fuqizimi i sistemit të Drejtësisë Penale 4.3. Fuqizimi i Qasjes në Drejtësi	Strategjia Kombëtare për Sundimin e Ligjit 2021-2025
Zbatimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor	Sipas këtij koncept dokumenti

Kapitulli 3: Opsionet

Në kuadër të këtij kapitulli, Koncept Dokumenti trajton pesë opsione kryesore lidhur me realizimin e të drejtave civile, përfshirë të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor:

- Opsioni 1 - Pa asnjë ndryshim i cili parasheh ruajtjen e status quo;
- Opsioni 2 – Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore;
- Opsioni 3 – Realizimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor përmes ndryshimeve ligjore;
- Opsioni 4 – Realizimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor përmes përmirësimit e zbatimit të legjislacionit aktual dhe ndryshimeve të reja ligjore;
- Opsioni 5 – Realizimi i të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme në Gjykatën Kushtetuese.

3.1. Opsioni “asnjë ndryshim”

Ky opsion nënkupton të mos bëhet “asnjë ndryshim” dhe të vazhdohet gjendja ekzistuese, duke mos miratuar një bazë të re ligjore për parashikimin e mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme, dhe duke mos ndërtuar as një sistem të masave dhe mekanizmave që bazuar në legjislacionin aktual të përmirësohet efektiviteti i mbrojtjes së kësaj të drejte. Si i tillë, ky opsion nuk mund të mbetet si alternativë, duke u bazuar në problemet dhe mangësitë e shumta sa i takon garantimit të së drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme dhe shfrytëzim të mjeteve juridike efektive, të cilat janë identifikuar edhe në këtë koncept dokument.

Problemet themelore lidhur me këtë opsion konsistojnë në:

- Mungesën e mjeteve efektive juridike që garantojnë mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Legjislacioni ekzistues i Kosovës nuk parasheh asnjë mjet juridik efektiv që parasheh mundësinë për kërkesë për përshpejtim të procedurës gjyqësore ankesë apo edhe kërkesë për kompensim të dëmit për rastet e vonesave të paarsyeshme në procedura gjyqësore.
- Mungesën e kriterëve të veçanta që përcaktojnë kohëzgjatjen mesatare (afatet e arsyeshme) për zgjidhjen e lëndëve (sipas fushës dhe natyrës së tyre) në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. KGJK (sikurse edhe Gjykata Supreme) dhe KPK (sikurse edhe Kryeprokurori i Shtetit) në asnjë dokument të tyre apo akt nënligjor (udhëzues, rregullore, udhëzim administrativ, vendim, etj.) nuk parashohin kriterë të veçanta për kohën mesatare (kohën e arsyeshme bazuar në kriterë objektive dhe të matshme) për zgjidhjen e lëndëve, dhe nuk mbajnë edhe të dhëna sa i takon këtij standardi.

Ligjvënësi në Kosovë ka miratuar një numër të konsiderueshëm të ligjeve nga fusha penale, civile dhe administrative, në të cilat me dispozita të përgjithshme parashihet e drejta për gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, por në asnjërin prej këtyre aktve nuk parashihen mjete juridike efektive të dedikuara për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Kjo mungesë, është e shprehur edhe në çështjet penale, që cilësohen me ndjeshmëri të lartë në kuptim të lirive dhe të drejtave të njeriut, si p.sh.: rastet kur është caktuar masa e paraburgimit, ku Kodi i Procedurës Penale, parasheh kriteret e përgjithshme për caktimin dhe kohëzgjatjen e tij, por nuk ka një mekanizëm të monitorimit të arsyetimit të vendimeve të tilla dhe një mbikëqyrje gjyqësore efektive që siguron që zbatimi i kësaj mase të lejohet vetëm si mjet i fundit (*ultima ratio*).

3.2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore

Në kuadër të këtij opsioni trajtohet mundësia e përmirësimit të situatës aktuale përmes përmbushjes së duhur të detyrimeve ekzistuese ligjore, qoftë edhe me mundësi të përkrahjes buxhetore. Në kuadër të këtij opsioni nuk mund të parashihen as intervenimet në aktet nënligjore, siç janë Rregulloret aktuale të KGJK-së dhe KPK-së.

Në këtë linjë, institucionet relevante që mund të ndërmarrin masa për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore, do të konsistojnë duke përfshirë, por pa u kufizuar, në:

Ministria e Drejtësisë: Të ndërmarr veprime për promovimin dhe fuqizimin e përdorimit të mekanizmave alternativë të zgjidhjes së konflikteve dhe profesioneve të lira.

KGJK: Të marrë në konsideratë planifikimet për rritjen e numrit të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjorë, bazuar në analiza të plota mbi nevojat reale, si një parakusht për kryerjen e lëndëve pa vonesa dhe respektimin e standardit për gjykim në kohë të arsyeshme. Kjo do të nënkuptonte edhe rritjen e buxhetit për gjyqësorin. Është thelbësore që Këshilli Gjyqësor i Kosovës të planifikojë rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës në mënyrë që të secili gjyqtar të ketë numër të menaxhueshëm të lëndëve/ ku norma e punës nuk do të ndikonte në tejkalimin e afateve për nxjerrjen e vendimit meritator. Në lidhje me numrin e gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional duhet të përgatitet një analizë e detajuar nga ana e Këshillit Gjyqësor ku do të arsyetohej numri i stafit të ri në raport me nevojën për zgjidhje të lëndëve dhe garantimin e gjykimit në kohë të arsyeshme, si edhe kosto buxhetore për rekrutimin e tyre. KGJK duhet që po ashtu të ndërmarrë masa në mënyrë që të eliminohet efekti ping – pong ashtu që Gjykata e Apelit, sipas Kodit të Procedurës Penale, të vendose meritorisht lidhur me ceshtjen dhe vetëm kur është e domosdoshme t'i ktheje lëndët për rigjykim. Ky aspekt, duhet të zgjidhet me një mendim juridik nga Gjykata Supreme ku të përcaktohet edhe detyrimi i arsyetimit të veçantë të vendimeve të Gjykatës së Apelit, në rastet e kthimit të çështjes në rigjykim, duke argumentuar se kjo është e domosdoshme. Gjithashtu, me këtë mendim juridik duhet të përcaktohet edhe standardi që Gjykata e Apelit të jape arsyetime dhe udhëzime të qarta për gjykatën e shkalles së parë.

Po ashtu, si pjesë e Opsionit 2, KGJK përmes mekanizmave të tij duhet të siguroj që shtyerja e çdo seance dhe arsyetimet për këtë shtyerje regjistrohen në SMIL nga të gjithë gjyqtarët. Veçanërisht, raportet periodike të kryetarëve të gjykatave për KGJK theksojnë numrin e

seancave të shtyra në raport me të gjitha seancat në kuadër të gjykatës, dhe arsyet për shtyrjen e tyre.

Gjykata Supreme: në ushtrim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, si instanca me e lartë gjyqësore në Kosovë, të nxjerr qëndrime parimore, mendime juridike dhe udhëzues të veçantë në lidhje me zbatimin e parimit për gjykim në kohë arsyeshme në të gjitha gjykatat e Kosovës. Në këtë mënyrë Gjykata Supreme do të sqaronte detyrimet kushtetuese, ato që dalin nga KEDNJ dhe praktika e GJEDNJ, si dhe legjislacioni tjetër në fuqi (*nga fusha penale, civile dhe administrative*) për zbatimin e standardit për gjykim brenda kohës së arsyeshme (*arsyetimin me shkrim të shtyrjes së seancave në shalle të parë dhe të dytë, shfrytëzimi i afateve brenda ligjit të jetë i arsyetuar me shkrim, kthimin për rivendosje të aktgjykimeve të Gjykatave Themelore vetëm kur është e domosdoshme, udhëzimin e gjykatave penale që të vendosin vetë për kërkesën pasusore juridike etj.*).

Në mënyrë të veçantë mendimet juridike të Gjykatës Supreme duhet të udhëzojnë zbatimin me prioritet të procedurave alternative për përfundimin e lëndëve gjyqësore, në të gjitha rastet kur kjo është e mundur sipas legjislacionit në fuqi. Tutje, Gjykata Supreme duhet të nxjerr mendime juridike dhe qëndrime parimore edhe në lidhje me respektimin e afateve ligjore të përcaktuara me ligj.

KPK: Të nxjerr me shkrim udhëzime dhe vendime të përgjithshme të detyrueshme për të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët me qëllim të ngritjes së efikasitetit në përfundimin e lëndëve brenda afateve të arsyeshme. Gjithashtu, të ushtroj mbikëqyrjen e vazhdueshme mbi zbatimin e këtyre standardeve të përcaktuara me aktet që i miraton, me qëllim të marrjes së masave që veprimet procedurale të kryhen në kohë.

Akademia e Drejtësisë: të hartoj një program të veçantë të trajnimit për gjyqtarët dhe prokurorët në lidhje me standardin e gjykimit në kohë të arsyeshme në procedurë penale, civile dhe administrative (*duke u referuar në standardet me të larta ndërkombëtare dhe praktikën e mira të vendeve tjera*). Një program i tillë do të duhej të përgatitej duke u bazuar në ekspertizë profesionale, bazuar në praktikën e GJEDNJ në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ. Përveç parimeve të përmbajtura në Kushtetutë, legjislacion, KEDNJ, programi duhet të parashoh edhe masat praktike në lidhje me zbatimin e parakushteve që garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme. P.sh.: në kuadër të procedurës penale, të referohen aspektet kryesore që nisin me fazën e hetimit (arsyetimin e kohëzgjatjes së hetimit edhe brenda afatit ligjor) Gjithashtu, është e nevojshme që Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në të publikoj doracak dhe materiale të ndryshme mbi zbatimin e standardit të gjykimit në kohë të arsyeshme.

Gjykata Kushtetuese: Sa i takon zbatimin të Opsionit 2, pa ndryshime ligjore, që do të nënkuptonte mos të ketë mjete efektive juridike ta parashikuara me ligj për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme, atëherë një rol edhe me të rëndësishëm ka juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kjo për arsye se derisa nuk ka mbrojtje gjyqësore për të drejtën për gjykim në kohë të arsyeshme, kjo do të mund të plotësohej në një masë me praktikën e Gjykatës Kushtetuese, e cila duke u referuar në nenin 31, *parag.2* të Kushtetutës, do të garantonte mbrojtjen e kësaj të drejte, edhe në këndvështrim të nenit 13 të KEDNJ (për mjetet juridike efektive) në lidhje me nenin 6, *parag.1* i konventës, bazuar edhe në standardet e afirmuara nga GJEDNJ në shumë raste të praktikës së saj. Kjo do kërkonte që Gjykata Kushtetuese të vazhdojë të pranojë kërkesat e palëve në lidhje me gjykimin në kohë të

arsyeshme, edhe pa i shterur të gjitha fazat e procedurës gjyqësore, derisa nuk ka mjete efektive për garantimin e kësaj të drejte në gjykatat e rregullta. Një praktikë e tillë, është argumentuar edhe nga Avokati i Popullit në vitin 2018, përmes Opinionit Ligjor në cilësinë e mikut të gjykatës (Amicus Curiae) për Gjykatën Kushtetuese (i elaboruar edhe në këtë koncept dokument). Sigurisht se edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese që do të vërtetonin shkeljen e të drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme, nuk mund të kenë efektin (p.sh.: për te realizuar një të drejtë për kompensim dëmi) dhe as të jenë zëvendësim adekuat për mjetet efektive juridike për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme, që do të përcaktoheshin me ligj.

3.3. Opsioni për realizimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor përmes ndryshimeve ligjore

Një opsion i mundshëm në lidhje me garantimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, konsiston në miratimin e një ligji të veçantë për këtë qëllim. Kjo do të nënkuptonte edhe përcaktimin e mjeteve juridike të veçanta (efektive) për mbrojtjen e kësaj të drejte.

Një ligj i tillë do të bazohej në parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku e drejta për gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm përcaktohet si liri dhe drejtë themelore e njeriut, e shprehur në garancinë kushtetuese se “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm...” (Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], par.2). Gjithashtu, kjo do të ishte në harmoni me kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ dhe nenin 13 për mjetet juridike efektive, që sipas nenit 22 të Kushtetutës janë të zbatueshme drejtpërdrejt në rendin juridik të Kosovës.


Miratimi i ligjit të ri parashih mundësinë e mjeteve efektive juridike në lidhje me mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme dhe të pritshme për palët, do të konsistonte në bazën ligjore për: paraqitje të kërkesës për përshpejtim të procedurës si dhe mundësinë e parashtrimt të kërkesës për kompensim.

Në këtë rast, kërkesa për përshpejtim të procedurës do të mund të parashtrohej nga palët gjatë procedurës deri në përfundim të saj, ndërsa kërkesës për kompensim mund të iniciohet pas përfundimit të procedurës së kërkesës për përshpejtim të procedurës në të cilën është konstatuar se ka pasur vonesa të pajustificueshme në procedurë. Ky ligj do të përcaktojë edhe rregullat kryesore mbi të cilat do të kornizohet afati i arsyeshëm kohor, pra kriteret të cilat gjykata do i marrë parasysh gjatë vendosjes së rastit që përfshijnë: kompleksitetin e çështjes, sjelljen e palëve, veprimet e gjykatës dhe autoriteteve të tjera shtetërore të përfshira në proces dhe rëndësinë e çështjes për personat që pretendojnë shkeljen.

Me ligjin e ri, përveç mjeteve efektive juridike, duhet të përcaktohen edhe organet kompetente që vendosin në lidhje me këto mjete juridike. Në këtë drejtim:

- a) Kërkesa për përshpejtim të procedurës vendoset nga kryetari i gjykatës pranë së cilës zhvillohet procedura gjyqësore. Lidhur me kërkesën përcaktohet edhe një afat për kthim të përgjigjes (shembull 60 ditë). Vendimi duhet të jetë i arsyetuar mirë dhe mund të


ankimohet tek kryetari i gjykatës më të lartë. Ndaj vendimit për kërkesën për përshpejtim të procedurës tek kryetari i Gjykatës Supreme, nuk lejohet ankesa.



b) Kërkesa për kompensim të dëmit dorëzohet pranë gjykatës kompetente sipas jurisdikcionit ligjor të gjykatave. Ligji duhet të përcaktojë afatin kohor brenda të cilit mund të dorëzohet kërkesa për kompensim pas marrjes së vendimit për përshpejtim të procedurës si dhe afatin kohor brenda të cilit duhet të vendoset mbi kërkesën për kompensim. Sa i takon ankesave ndaj vendimeve të gjykatës kompetente mbi kërkesën për kompensim, vlejné rregullat e të drejtës në ankesë në gjykatën më të lartë.



Në formë vizuale, së bashku procedura e kërkesës për përshpejtim të procedurës dhe ngritjes së kërkesës për kompensim do të dukej si në vijim:



Sa i takon procedurës penale, pjesë e saj është faza e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës që zhvillohet nga Prokurori i Shtetit (që sipas legjislacionit të Kosovës është autoriteti kompetent për hetimet e çështjeve penale), andaj, kërkesa për përshpejtim të procedurës, ankesa dhe kërkesa për kompensim duhet të njihen si e drejtë e palëve edhe për këtë fazë të procedurës penale. Një praktikë e tillë njihet edhe në sistemin vendeve tjera evropiane (si p.sh.: Belgjikë (ku kërkesa mund të parashtrohet jo vetëm nga i pandehuri por edhe nga avokati i shtetit), Bullgaria, Danimarka, Portugalia, ku secila palë mund të bëjë kërkesë edhe në lidhje me procedurën para prokurorisë, për përshpejtim të procedurës⁵⁹).

Mekanizmat si më lartë, që do të përcaktoheshin me ligjin e ri vlejné për të gjitha procedurat gjyqësore.⁶⁰ Ligji i ri për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme, do të duhej të përcaktonte afatet e përgjithshme të kohëzgjatjes së zgjidhjes së lëndëve penale, civile dhe administrative, si edhe parimet e përgjithshme në këtë drejtim. Në anën tjetër, ligji do të parashikonte edhe obligimin e KGJK-së dhe KPK-së për miratimin e rregulloreve përkatëse për caktimin e kriterëve të sakta mbi kohën e arsyeshme (mesatare) të zgjidhjes së lëndëve, varësisht nga natyra e tyre, si dhe mekanizmeve për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve për këtë qëllim.

59 Për me shumë mbi këtë aspekt shih edhe Raporti i Komisionit të Venecias (REPORT ON THE EFFECTIVENESS OF NATIONAL REMEDIES IN RESPECT OF EXCESSIVE LENGTH OF PROCEEDINGS (Adopted by the Venice Commission at its 69th Plenary Session (Venice, 15-16 December 2006)), parag.81-86.

⁶⁰ Për me tepër, ky standard është i sqaruar edhe me praktikën e GJEDNJ, në kuptimin se mjetet juridike për këtë qëllim nuk mund të jenë ekskluzive për një procedurë të caktuar (me shumë shih edhe: Gast and Popp kundër Gjermanisë, 2005), por, të gjitha veprimet e bazuara në kushtetutë dhe legjislacion që synojnë përshpejtimin e procedurës, kompensimin e dëmit apo edhe aplikimin e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, mund të shfrytëzohen për shkeljet e pretenduara të kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurës në çështjet penale, njëjtë si edhe në procedurat në lidhje me çështjet e tjera (civile, administrative). Shih Raporti i Komisionit të Venecias, *Ibid.*


3.4. Opsioni për realizimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor përmes përmirësimit e zbatimit të legjislacionit aktual dhe ndryshimeve të reja ligjore

Një opsion i mundshëm i adresimit të problemit të elaboruar në këtë koncept dokument është kombinimi i masave të parapara nën Opsionin 2 dhe ndryshimeve ligjore të përshkruara nën Opsionin 3.

Rrjedhimisht, sipas opsionit 2 përfshihen ndërmarrja e masave për përmirësimin e situatës aktuale përmes përmbushjes së duhur të detyrimeve ekzistuese ligjore, qoftë edhe me mundësi të përkrahjes buxhetore. Këto masa ndërmerren nga institucionet si: KGJK, Kryeprokurori i shtetit, Gjykata Supreme, Akademia e Drejtësisë. Përrjashtimisht, nga opsioni 2 nuk përfshihet vetëm masa e parapare për Gjykatën Kushtetuese, e cila nuk ka nevojë të vijojë me adresimin e ankesave lidhur me shkeljen e të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme, meqë kjo masë do të zëvendësohet me pjesën e ndryshimeve të reja ligjore e cila do të bëhet nëpërmjet dy mjeteve juridike të reja (kërkesa për përshpejtim të procedurës dhe kërkesa për kompensim).

Kurse, të gjitha masat dhe veprimet e parapara nën opsionin 3 do të vlejnjë edhe për këtë opsion. Rrjedhimisht, parashihet miratimi i një ligji të ri për realizimin e të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Me ligjin e ri, do të ipet bazë ligjore për dy mjete juridike efektive: Kërkesa për përshpejtim të procedurës dhe Kërkesa për kompensim të dëmit. Në këtë rast, kërkesa për përshpejtim të procedurës do të mund të parashtrahet nga palët gjatë procedurës deri në përfundim të saj, ndërsa kërkesa për kompensim mund të iniciohet pas përfundimit të procedurës së kërkesës për përshpejtim të procedurës në të cilën është konstatuar se ka pasur vonesa të pajustificueshme në procedurë. Ky ligj do të përcaktojë edhe rregullat kryesore mbi të cilat do të kornizohet afati i arsyeshëm kohor, pra kriteret të cilat gjykata do i marrë parasysh gjatë vendosjes së rastit që përfshijnë: kompleksitetin e çështjes, sjelljen e palëve, veprimet e gjykatës dhe autoriteteve të tjera shtetërore të përfshira në proces dhe rëndësinë e çështjes për personat që pretendojnë shkeljen. Ligji do të përcaktojë po ashtu edhe organet kompetente që vendosin në lidhje me këto mjete juridike. Në këtë drejtim:

- a) Kërkesa për përshpejtim të procedurës vendoset nga kryetari i gjykatës pranë së cilës zhvillohet procedura gjyqësore. Lidhur me kërkesën përcaktohet edhe një afat për kthim të përgjigjes (shembull: 60 ditë). Vendimi duhet të jetë i arsyetuar mirë dhe mund të ankimohe tek kryetari i gjykatës më të lartë. Ndaj vendimit për kërkesën për përshpejtim të procedurës tek kryetari i Gjykatës Supreme, nuk lejohet ankesa.



b) Kërkesa për kompensim të dëmit dorëzohet pranë gjykatës kompetente sipas jurisdiksionit ligjor të gjykatave. Ligji duhet të përcaktojë afatin kohor brenda të cilit mund të dorëzohet kërkesa për kompensim pas marrjes së vendimit për përshpejtim të procedurës si dhe afatin kohor brenda të cilit duhet të vendoset mbi kërkesën për kompensim. Sa i takon ankesave ndaj vendimeve të gjykatës kompetente mbi kërkesën për kompensim, vlejnjë rregullat e të drejtës në ankesë në gjykatën më të lartë.



3.5. Opsioni i realizimit të së drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme në Gjykatën Kushtetuese

Një opsion i vlefshëm për të arritur realizimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor është edhe realizimi i kësaj të drejtë nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese. Siç është sqaruar në këtë koncept dokument, tashmë Gjykata Kushtetuese ka edhe precedent të rasteve ku ka vendosur lidhur me gjykimin brenda kohës së arsyeshme. Meqë, tashmë ekziston një mundësi e tillë, ky opsion do të mundësonte që Gjykatës Kushtetuese t'i ipet një kompetencë e tillë edhe

shprehimisht me ligj. Kjo mund të bëhet nëpërmjet ndryshimit të Ligjit aktual për Gjykatën Kushtetuese.

Fillimisht, parimet bazë të funksionimit dhe organizimit të Gjykatës Kushtetuese janë të rregulluara me Kushtetutë. Kapitulli VIII parasheh parimet e përgjithshme, jurisdiksionin dhe palët e autorizuara, përbërjen dhe mandatin, organizimin, efektin juridik të vendimeve dhe çështje të tjera thelbësore të funksionimit të Gjykatës. Në nenin 113 listohen rastet dhe palët e autorizuara mbi të cilat vendos Gjykata. Mirëpo, në paragrafin 10 të të njëjtit nen përcaktohet që jurisdiksioni shtesë mund të rregullohet me ligj.

Në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, më saktësisht në Kreun III rregullohen procedurat e veçanta lidhur me procedurat e përcaktuara me nenin 113 të Kushtetutës. Andaj, në bazë të këtij opsioni, realizimi i të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme mund të bëhet përmes ndryshimit të ligjit për Gjykatën Kushtetuese në të cilin do të shtohet një procedurë e re e veçantë. Saktësisht, pas nenit 54 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese do të shtoheshin nenet e reja të cilat do të rregullojnë procedurën për ngritjen e kërkesës për kompensim nga individët lidhur me pretendimin për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor. Në ndryshime përfshihen edhe afatet brenda të cilave vendos Gjykata, që ngjajshmërisht me procedurat tjera pranë kësaj Gjykate mund të jetë 60 ditë. Po ashtu, do të qartësohej se si në këtë procedurë të veçantë obligimi për shterjen e të gjitha mjeteve juridike nga individët nuk do të vlejë, pra kërkesa për kompensim të bëhet gjatë zhvillimit të procedurës respektive gjyqësore kur pala pretendon se gjykimi nuk i është bërë brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Pjesa tjetër lidhur me procedurat për kërkimin e kësaj të drejte rregullohen me ligj të veçantë për gjykimin brenda kohës së arsyeshme. Ky ligj do të përcaktojë rregullat kryesore mbi të cilat do të kornizohet afati i arsyeshëm kohor, pra kriteret të cilat gjykata do i marrë parasysh gjatë vendosjes së rastit që përfshijnë: kompleksitetin e çështjes, sjelljen e palëve, veprimet e gjykatës dhe autoriteteve të tjera shtetërore të përfshira në proces dhe rëndësinë e çështjes për personat që pretendojnë shkeljen. Ligji përmban edhe limitet e vlerave të kompensimit në rast se Gjykata vërteton shkeljen e gjykimit brenda kohës së arsyeshme. Ligji do të sqarojë procedurën se pranë Gjykatës Kushtetuese dorëzohet kërkesa për kompensim të dëmit nga shkelja e të drejtës për gjykim në kohë të arsyeshme dhe se Gjykata Kushtetuese do të këtë kompetencë që në rast se konstaton shkeljen e kësaj të drejte t'i japë palës edhe kompensimin financiar në bazë të ligjit. Duhet theksuar se ky opsion do të ndikonte në rritjen e volumit të punës për Gjykatën Kushtetuese në masë të konsiderueshme.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar në këtë fazë lidhur me këtë politikë. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet përidentifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore.

Figura 3: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	Rritja e efikasitetit dhe procedimit të shpejtë të lëndëve sidomos ato të natyrës civile do të ndikojë pozitivisht për përmirësimin e kushteve për operimin e bizneseve ekzistuese, si dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Përmirësimi i qasjes në drejtësi do të rrisë sigurinë juridike për bizneset si dhe do të ndikojë edhe në tërheqjen e investimeve të huaja direkte, të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës.
Ndikimet shoqërore	Kohëzgjatja e procedurave mbetet një nga çështjet më kritike dhe komplekse të sektorit të sundimit të ligjit. Ajo ndikon drejtpërdrejtë në të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, siç përcaktohet me Kushtetutë dhe KEDNJ. Sipas të gjeturave nga monitorimi i organizatave ndërkombëtare dhe atyre vendore, besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë vazhdon të mbetet i ulët. Zvarritja e vazhdueshme e procedimit të lëndëve e sidomos të atyre të natyrës civile është faktor kyç në cënimin e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor. Për më tepër palëve ju mungon një mjet efektiv juridik për përshpejtimin e procedurave, në rastet e vonesave të konsiderueshme për zgjidhjen e rasteve të tyre, si dhe mundësia e kompensimit për vonesat e tilla. Nxjerrja e legjislacionit për gjykimin brenda kohës e arsyeshme ku parashihen mjetet efektive juridike dhe krijimi dhe fuqizimi i mekanizmave që synojnë respektimin e nenit 6 të Konventës Evropiane, do të përmirësojë qasjen në drejtësi të qytetarëve, efikasitetin dhe llogaridhënien e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe si rezultat do të kontribuojë në rikthimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe respektimin e të drejtës së palës për gjykim brenda kohës së arsyeshme.
Ndikimet mjedisore	Çështjet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit do të trajtohen në mënyrë më efikase dhe në kohë.
Ndikimet në të drejtat themelore	E drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme është e drejtë themelore procedurale e njeriut e garantuar me Kushtetutën e Kosovës dhe Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Shtetet kanë detyrimin e përgjithshëm për të zgjidhur problemet në të cilat shtrihen shkeljet e gjetura dhe të sigurojnë që mjetet juridike kombëtare janë efektive në ligj dhe në praktikë. Mungesa e këtyre mjeteve efektive juridike, është mos përmbushje efektive e një prej garancive të Kushtetutës (neni 31, <i>parag.2</i>), si edhe kërkesës së nenit 13 të KEDNJ për mjete juridike efektive.

	Miratimi i një ligji të veçantë për gjykimin brenda kohës së arsyeshme dhe krijimit të mekanizmave për monitorimin e afërt të rasteve gjyqësore, do të garantonte që e drejta e palës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të respektohet. Kjo do të nënkuptonte edhe përcaktimin e mjeteve juridike të veçanta (efektive) për mbrojtjen e kësaj të drejte.
Ndikimi gjinor	Ndërhyrjet e propozuara sipas Opsioneve më sipër, në mënyrë të barabartë dhe adekuate, prodhojnë rezultat si për burrat, ashtu edhe për gratë.
Ndikimet e barazisë sociale	Nuk parashihet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë tek barazia sociale.
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk parashihet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë tek të rinjtë.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Nuk parashihet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në ngarkesën administrative.
Ndikimi i NMV-ve	Nuk parashihet të ketë ndikim të drejtpërdrejt në NVM-v

4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Grupi punues për hartimin e këtij Koncept Dokumenti përbëhet nga akterë të ndryshëm relevant si brenda institucioneve të Kosovës, ashtu edhe jashtë saj. Si rrjedhojë, nuk janë hasur sfida në mbledhjen e të dhënave që janë nevojitur për kryerjen e analizave në këtë Koncept Dokument.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Ministria e Drejtësisë me themelimin e grupit punues për hartimin e këtij koncept dokumenti ka përfshirë në grup punues akterët kryesor të interesuar për procesin të cilët kanë pasur mundësinë të kontribuojnë drejtpërdrejtë në hartimin dhe analizimin e këtij dokumenti.

Pas përfundimit të draftit të parë të Koncept Dokumentit, i njëjti është përcjellë në konsultim paraprak dhe konsultimi publik për të gjitha institucionet, organizatat dhe partnerët tjerë të cilat nuk e kanë pasur mundësinë që të jenë pjesë e grupit të tyre, dhe kjo ishte një platformë e mirë që të ofrojnë kontributin e tyre për t'i pasuruar tutje analizat që janë bërë. Për fund, planifikohet të zhvillohen edhe aktivitetet e komunikimit të kësaj politike të re, në përputhje me opsionin e rekomanduar.

Figura 4: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Procesi i konsultimit synon:						
- Konsultimin e palëve të interesuara për përmbajtjen e Koncept Dokumentit, dhe veçanërisht për opsionet e shqyrtuara dhe ndikimin e vlerësuar të tyre.						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Konsultim paraprak me shkrim	Grupi punues	Konsultim i brendshëm	Përmes e-mailit	13.04.2022-20.04.2022	/	Albulena Uka/MD
Konsultimi paraprak	Institucionet e Republikës së Kosovës	Dërgimi i koncept dokumentit tek institucionet relevante	Përmes e-mailit		/	Ruzhdi Osmani/DIEKP /MD
Konsultimi publik me shkrim	Të gjitha palët e interesuara	Publikimi i koncept dokumentit në portalin për konsultim publik	Përmes portalit për konsultime		/	Albulena Uka/MD

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Për të adresuar problemet e analizuara në këtë koncept dokument janë propozuar pesë opsione konkrete, ku secila parasheh modalitete të ndryshme të zbatimit. Në këtë seksion do të krahasohen ato mes vete, duke përdorur analizën shumë-kriterëshe. Kjo metodologji merr parasysh kriteret: efikasiteti, efektiviteti, etikën dhe koston. Fillimisht, për të kuptuar se sa efikase janë opsionet e ndryshme, është bërë, duke u bazuar në opsionet e zhvilluara, llogaritja e koston të secilit opsion, marr parasysh kategoritë e shpenzimeve për vitet 2023-2026 të zbatimit të Koncept Dokumentit.

Fillimisht, Opsioni 1 i cili nuk parasheh ndërmarrjen e ndonjë veprimi apo ndryshimi ligjor, por që konsiston me vazhdim të gjendjes aktuale, nuk përbën zgjidhje të problemit në lidhje me standardin e gjyqimit në kohë të arsyeshme dhe mundësinë e mjeteve juridike efektive për

mbrojtjen e kësaj të drejte. Përkundrazi, mbajtja e gjendjes aktuale pa asnjë ndryshim, nënkupton vazhdimin e pasojave, si: Të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të Kosovës në lidhje me qasjen në drejtësi dhe mjetet juridike efektive nuk do të respektohen në përputhje me Kushtetutë, jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe frymën e KEDNJ-së, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, si dhe me “acqui” përkatës të BE-së. Pra, me zbatimin e këtij opsioni, parimi i gjyqimit brenda kohës së arsyeshme do të vazhdojë të shkelet. Po ashtu, ky opsion do të bëjë që të ketë rënie të besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, duhet të theksohet se përparësia e vetme e zbatimit të këtij opsioni është se nuk do të kishte një kosto shtesë.

Më tej, Opsioni 2 i cili parasheh ndërmarrjen e masave për përmirësimin dhe zbatimin e legjislacionit aktual pa ndryshime ligjore nuk mund të rezultojë me zgjidhjen e plotë të problemit. Ndonëse ky opsion propozon një ndërhyrje në situatën aktuale, kjo është e limituar meqë me këtë opsion nuk parashihen ndryshime të natyrës ligjore. Opsioni 2 do të rriste efikasitetin e zbatimit të standardit për gjykim brenda kohës së arsyeshme, por kjo do të varej nga efikasiteti i masave që do të ndërmerren nga organet e sistemit të drejtësisë dhe mekanizmat që do të krijoheshin për këtë qëllim. Duke mos krijuar një bazë ligjore të veçantë, arritja e këtij standardi do të bazohet në integritetin dhe përgjegjshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në përmbushjen e detyrave, njohuritë e thelluara në lidhje me KEDNJ dhe standardet e GJEDNJ, ku përveç përgatitjes bazë, kërkohet të ketë edhe trajnime specifike për këtë qëllim. Në anën tjetër, ky opsion nuk do të përbente zgjidhje të plotë të problemit, sidomos në lidhje me mjetet efektive juridike për mbrojtje gjyqësore të së drejtës për gjykim të drejtë (që do të mund të krijoheshin me ligj). Si përfitim mund të llogaritet fakti se nuk do të ketë kosto të mëdha buxhetore si rrjedhojë e zbatimit të këtij opsioni.

Opsioni 3 i cili konsiston në miratimin e një ligji të veçantë për realizimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor, ka të bëjë edhe me faktin se në një akt të vetëm do të adresoheshin shumica e masave dhe mjeteve efektive për garantimin e gjyqimit brenda një kohe të arsyeshme, për të gjitha procedura gjyqësore (penale, civile dhe administrative). Për më tepër, përcaktimi i mjeteve efektive juridike me ligj të veçantë, që do t’u mundësonte palëve të bëjnë kërkesë për përshpejtim të procedurës tek kryetarët e gjykatave përkatëse me mundësi ankese tek gjykata e shkallës më të lartë dhe kërkesë për kompensim dëmi gjë që do të fuqizonte edhe mundësinë e mbrojtjes efektive të së drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Miratimi i ligjit të ri për këtë qëllim, do të nënkuptohej se në sistemin juridik të Kosovës të përfshihen mekanizma të veçantë, të cilët do të ofronin garanci shtesë për qytetarët që të realizojnë të drejtën e tyre për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duke iu vënë në dispozicion edhe mjete juridike të veçanta. Mbi këtë bazë, duhet theksuar se sigurimi i mjeteve efektive juridike të ankimit në këndvështrim të nenit 13 të KEDNJ-së, në rastin e Kosovës bartë me vete edhe specifikën se shteti i Kosovës nuk është anëtar në Këshillin e Evropës, rrjedhimisht as palë e KEDNJ dhe nuk ka akoma asnjë rast që është trajtuar nga GJEDNJ, e cila do të vlerësonte nivelin e garancisë për të drejtën në gjykim brenda një kohe të arsyeshme nga sistemi i drejtësisë në Kosovë, në kuptim të nenit 6, *parag.1* të KEDNJ. Kjo, natyrshëm e bën edhe me të domosdoshme marrjen e masave me të gjëra në këtë drejtim, përfshirë edhe miratimin e një bazë ligjore të veçantë për mbrojtjen gjyqësore të kësaj të drejte, përmes krijimit të mjeteve adekuate juridike. Përparësi e këtij opsioni është se nëpërmjet tij do të krijohet baza ligjore për realizimin e kësaj të drejte në mënyrë efektive. Mirëpo, mangësi e të njëjtit mund të konsiderohet kostoja

buxhetore që potencialisht mund t'i bëhet barrë shtetit për kompensimin e të gjitha palëve që iu konfirmohet së iu është shkelur e drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme.

Opsioni 4 - Përparësia kryesore e këtij opsioni konsiston në adresimin e problematikës së zvarritjes të procedurave gjyqësore nga shumë aspekte duke përfshirë edhe zbatimin e legjislacionit aktual si dhe ndryshimeve të reja ligjore. Nëpërmjet zbatimit të legjislacionit aktual parashihet një mbështetje më e madhe financiare në realizimin e masave të parapara për institucionet relevante si KGJK, KPK, Gjykata Supreme, Akademia e Drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese. Mirëpo nëpërmjet ndryshimeve ligjore, respektivisht miratimit të një ligji të ri parashihet krijimi i mundësisë dhe mjetit ligjor për kërkimin dhe realizimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor në sistemin e gjykatave të rregullta, respektivisht tek kryetarët e gjykatave përkatëse dhe ankimimit tek kryetarët e gjykatave më të larta. Këto mjete ligjore do t'i mundësonin palëve në procedura gjyqësore të kërkojnë përshpejtimin e procedurës dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zvarritja e procesit gjyqësor. Megjithatë, mangësi e këtij opsioni mund të konsiderohet kostoja që bartë si opsioni me koston më të lartë për shkak të numrit më të madh të masave që përmban. Kësaj kostoje i shtohet potencialisht edhe numri i kërkesave të palëve për kompensim dëmi të cilëve iu konfirmohet shkelja e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Opsioni 5 i cili parasheh realizimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese. Sipas këtij opsioni do të bëhet ndryshimi i ligjit aktual për Gjykatën Kushtetuese në të cilin do të i ipet jurisdiksion shtesë Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të këtij opsioni, realizimi i të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme mund të bëhet përmes ndryshimit të ligjit për Gjykatën Kushtetuese në të cilin do të shtohet një procedurë e re e veçantë për procedurën e ngritjes së kërkesës për kompensim nga individët lidhur me pretendimin për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor. Pjesa tjetër lidhur me procedurat për kërkimin e kësaj të drejte rregullohen me ligj të veçantë për gjykimin brenda kohës së arsyeshme. Me këtë ligj do përcaktohen rregullat kryesore mbi të cilat do të kornizohet afati i arsyeshëm kohor, pra kriteret të cilat gjykata do i marrë parasysh gjatë vendosjes së rastit. Si i tillë, ky opsion ka përparësi meqë do krijohet një rrugë për realizimin e të drejtës e cila tashmë veçse është e njohur mirëpo do i shtohet edhe pjesa e akordimit të dëmit direkt Gjykatës Kushtetuese, përveç konfirmimit të shkeljes së të drejtës. Përparësi e opsionit 5 konsiderohet fakti që procedura për palët do të jetë e thjeshtë dhe efektive. Gjithsesi, mangësi e këtij opsioni konsiderohet fakti që Gjykata Kushtetuese mund të mbingarkohet me kërkesa në një periudhë shumë të shpejt dhe rrjedhimisht do të binte efikasiteti i kësaj gjykate, andaj nuk do të arrihej as edhe vendosja në kërkesat për realizimin e të drejtës brenda kohës së arsyeshme dhe kompensimit të dëmit. Po ashtu, ngajshëm me dy opsionet paraprake, mangësi e këtij opsioni mund të konsiderohet edhe kostoja shtesë që potencialisht mund t'i bëhet barrë shtetit me ofrimin e mundësisë për kompensimin e palëve të cilave i'u është shkelur e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor.

6.1. Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Figura 5: Plani i zbatimit për Opsionin 2

Realizimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor								Kosto e pritur
Zbatimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor								
Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës								
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.1 E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor e zbatuar nga gjyqësori	Aktiviteti 1.1.1 - Rritja e buxhetit për gjyqësorin	x					Kuvendi	
	Aktiviteti 1.1.2 - Hartimi i planit dhe analizës së detajuar për planifikimin e rritjes së numrit të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional, zyrtarëve ligjorë dhe infrastrukturës së TI	x					KGJK	
	Aktiviteti 1.1.3 - Miratimi i Udhëzimit për eliminimin e efektit "ping - pong" në gjykata	x					KGJK	
	Aktiviteti 1.1.4 - Hartimi i Udhëzuesit të veçantë në lidhje me zbatimin e parimit për gjykim në kohë arsyeshme në të gjitha gjykatat e Kosovës	x					Gjykata Supreme	
	Aktiviteti 1.1.5 - Nxjerrja e 2 mendimeve juridike nga Gjykata Supreme lidhur me respektimit e standardit për gjykim brenda kohës	x					Gjykata Supreme	

	së arsyeshme							
	Aktiviteti 1.1.6 - Hartimi dhe miratimi i Udhëzuesit për regjistrimin në SMIL të shtyerjes dhe arsyetimit për çdo seancë	x					KGJK	
	Aktiviteti 1.1.7 - Hartimi i raporteve periodike të kryetarëve të gjykatave që përfshinë të dhënat për numrin e seancave të shtyera dhe arsyetimin	x					KGJK	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.2 E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm e zbatuar nga prokuroria	Aktiviteti 1.2.1 - Hartimi i Udhëzuesit të veçantë në lidhje me zbatimin e parimit për gjykim në kohë arsyeshme në fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës	x					KPK, Kryeprokurori i shtetit	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	

Outputi 1.3 Gjyqtarët të trajnuar për gjykimin brenda afatit të arsyeshëm kohor	Aktiviteti 1.3.1 - Hartimi i një programi të veçantë të trajnimit për gjyqtarë në lidhje standardin e gjyimit në kohë të arsyeshme duke u referuar edhe në standardet më të larta ndërkombëtare dhe praktikatat e mira të vendeve tjera	x					AD, KGJK	
	Aktiviteti 1.3.2 - Mbajtja e 5 trajnimeve nga Akademia e Drejtësisë për gjyqtarë lidhur me respektimin e standardit për gjykim brenda kohës së arsyeshme	x					AD	

Figura 6: Plani i zbatimit për Opsionin 3

Realizimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor								Kosto e pritur
Zbatimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor								
Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës								
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.1 Legjislacioni për të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme i miratuar	Aktiviteti 1.1.1 - Hartimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme	x					MD	
	Aktiviteti 1.1.2 – Konsultimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme	x					MD	
	Aktiviteti 1.1.3 - Procedimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme për miratim	x					MD	
	Aktiviteti 1.1.4 – Miratimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme	x					Kuvendi	
	Aktiviteti 1.1.5 - Miratimi i aktit nënligjor nga KGJK që përcakton kohën mesatare (me kritere objektive dhe të matshme) për zgjidhjen e lëndëve, në varësi të llojit dhe natyrës së tyre	x						KGJK

Figura 10: Plani i zbatimit për Opsionin 4

Realizimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor								Kosto e pritur
Zbatimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor								
Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës								
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.1 E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor e zbatuar nga gjyqësori	Aktiviteti 1.1.1 - Rritja e buxhetit për gjyqësorin	x					Kuvendi	
	Aktiviteti 1.1.2 - Hartimi i planit dhe analizës së detajuar për planifikimin e rritjes së numrit të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional, zyrtarëve ligjorë dhe infrastrukturës së TI	x					KGJK	
	Aktiviteti 1.1.3 - Miratimi i Udhëzimit për eliminimin e efektit "ping - pong" në gjykata	x					KGJK	
	Aktiviteti 1.1.4 - Hartimi i Udhëzuesit të veçantë në lidhje me zbatimin e parimit për gjykim në kohë arsyeshme në të gjitha gjykatat e Kosovës	x					Gjykata Supreme	
	Aktiviteti 1.1.5 - Nxjerrja e 2 mendimeve juridike nga Gjykata Supreme lidhur me respektimit e standardit për gjykim brenda kohës së	x					Gjykata Supreme	

	arsyeshme							
	Aktiviteti 1.1.6 - Hartimi dhe miratimi i Udhëzuesit për regjistrimin në SMIL të shtyerjes dhe arsyetimit për çdo seancë	x					KGJK	
	Aktiviteti 1.1.7 - Hartimi i raporteve periodike të kryetarëve të gjykatave që përfshinë të dhënat për numrin e seancave të shtyera dhe arsyetimin	x					KGJK	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.2 E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor e zbatuar	Aktiviteti 1.2.1 - Hartimi i Udhëzuesit të veçantë në lidhje me zbatimin e parimit për gjykim në kohë arsyeshme në fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës	x					KPK, Kryeprokurori i shtetit	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.3 Gjyqtarët të trajnuar për gjykimin brenda afatit të	Aktiviteti 1.3.1 - Hartimi i një programi të veçantë të trajnimit për gjyqtarë në lidhje standardin e gjykimin në kohë të arsyeshme duke u referuar edhe në standardet më të larta ndërkombëtare dhe praktikën e mira të vendeve	x					AD, KGJK	

	tjera							
	Aktiviteti 1.3.2 - Mbajtja e 5 trajnimeve nga Akademia e Drejtësisë për gjyqtarë lidhur me respektimin e standardit për gjykim brenda kohës së arsyeshme	x					AD	
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.2 Legjislacioni për të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme i miratuar	Aktiviteti 1.2.1 - Hartimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme	x					MD	
	Aktiviteti 1.2.2 – Konsultimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme	x					MD	
	Aktiviteti 1.2.3 - Procedimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme për miratim	x					MD	
	Aktiviteti 1.2.4 – Miratimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme	x					Kuvendi	
	Aktiviteti 1.2.5 - Miratimi i aktit nënligjor nga KGJK që përcakton kohën mesatare (me kritere objektive dhe të matshme) për zgjidhjen e lëndëve, në varësi të llojit dhe natyrës	x						KGJK

së tyre								
---------	--	--	--	--	--	--	--	--

Figura 10: Plani i zbatimit për Opsionin 5

Realizimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor								Kosto e pritur
Zbatimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor								
Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës								
Outputi	Aktiviteti	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Outputi 1.1 E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor e zbatuar në Gjykatën Kushtetuese	Aktiviteti 1.1.1 - Hartimi i Ligjit për plotësimin ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese	x					MD	
	Aktiviteti 1.1.2 - Konsultimi i Ligjit për plotësimin ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese	x					MD	
	Aktiviteti 1.1.3 - Procedimi i Ligjit për plotësimin ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese për miratim	x					MD	
	Aktiviteti 1.1.4 - Miratimi i Ligjit për plotësimin ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese	x					Kuvendi	

Outputi 1.2 Legjislacioni për të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme i miratuar	Aktiviteti 1.2.1 - Hartimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme	x					MD	
	Aktiviteti 1.2.2 – Konsultimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme	x					MD	
	Aktiviteti 1.2.3 - Procedimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme për miratim	x					MD	
	Aktiviteti 1.2.4 – Miratimi i Ligjit për gjykim brenda kohës së arsyeshme	x					Kuvendi	
	Aktiviteti 1.2.5 - Akti nënligjor nga KGJK që përcakton kohën mesatare (me kritere objektive dhe të matshme) për zgjidhjen e lëndëve, në varësi të llojit dhe natyrës së tyre, i miratuar.	x					KGJK	

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

Lidhur me koston e pritur, koncept dokumentit i bashkëngjitet edhe Vlerësimi i Ndikimit Financiar.

Figura 7: Krahasimi i opsioneve

Mjeti i krahasimit:			
Ndikimet relevante pozitive	Opsioni 1: Asnjë ndryshim	Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit	Opsioni 3:

Ndikimet relevante negative										
Kostot relevante										
Vlerësimi i ndikimit pritshëm buxhetor	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	
Përfundimi										

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Në bazë të analizave të bëra në këtë Koncept Dokument dhe marr parasysh krahasimin e opsioneve të shqyrtuara, në mënyrë që të eliminohen problemet e identifikuara dhe të arrihen objektivat e caktuara, Qeverisë i rekomandohet miratimi i Opsionit 4, gjegjësisht realizimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor përmes përmirësimit e zbatimit të legjislacionit aktual dhe ndryshimeve të reja ligjore. Plani i zbatimit të opsionit të rekomanduar është paraqitur në Kapitullin 6 të këtij dokumenti.

7.1. Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Monitorimi i zbatimit të këtij Opsioni, marr parasysh që përfshin institucionet nga tre pushtetet: legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin, do të bëhet nga të tre këto. Lidhur me zbatimin e Koncept Dokumentit do të përgatiten raporte vjetore me qëllim të informimit të institucioneve të cekura si më lartë. Vlerësimi ex-post sipas metodologjisë së përcaktuar do të bëhet në vitin e 5 të zbatimit të Koncept Dokumentit.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet e punës ⁶¹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X			
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		X			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		X			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		X			
	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		X			
	A do të krijohen biznese të reja?		X			
Ngarkesa	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënjes së		X			

⁶¹ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

administrative	informatave të reja?				
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënjes së informatave për bizneset?		X		
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		X		
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		X		
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		X		
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		X		
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		X		
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		X		
	A do të rriten investimet nga diaspora?		X		
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		X		
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		X		
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		X		

Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		X			
	A do të ulët çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		X			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		X			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		X			
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?		X			
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		X			
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		X			
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		X			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		X			
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?		X			
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		X			

Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?		X			
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		X			

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet e punës ⁶²	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		X			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X			
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		X			
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		X			
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të		X			

⁶² Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

	rezikshme?					
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		X			
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		X			
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		X			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		X			
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		X			
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		X			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		X			
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		X			
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?		X			
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?		X			
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		X			

	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		X			
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?		X			
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		X			
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		X			
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		X			
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?		X			
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	X				
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	X				
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		X			
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		X			

Shëndeti dhe siguria publike ⁶³	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		X			
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		X			
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		X			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		X			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		X			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		X			
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		X			
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të		X			

⁶³ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

	përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?					
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?		X			
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?		X			
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		X			
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	X				
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?	X				

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		X			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		X			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		X			
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		X			
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		X			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		X			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave		X			

	nëntokësore?					
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		X			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		X			
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		X			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		X			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		X			
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara?		X			
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		X			
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		X			
Përdorimi i	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave		X			

burimeve	të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?					
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		X			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		X			
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		X			
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		X			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		X			
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		X			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		X			
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		X			
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		X			
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		X			

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?	X				
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		X			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?	X				
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		X			
Të dhënat	A përfshin opsioni përpunimin e të					

personale	dhënave personale?					
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?	X				
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	X				
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		X			
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?		X			
Trajtimi i barabartë ⁶⁴	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	X				
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		X			

⁶⁴ Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*

Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		X			
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?		X			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?		X			
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		X			
	A ndikohet qasja në drejtësi?	X				